




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE I NAUKE
MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE



VLERËSIMI PËRMBLEDHËS HARTIMI I TESTIT

DORACAK PËR MËSIMDHËNËSIT PARA DHE NË SHËRBIM



Implementet by
giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



VLERËSIMI PËRMBLEDHËS HARTIMI I TESTIT

DORACAK PËR MËSIMDHËNËSIT
PARA DHE NË SHËRBIM

Publikuar:

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Projekti:

Ngritja e Kapaciteteve në Sektorin e Arsimit Fillor në Kosovë

Autorë:

Alfons Harizaj

Mustafë Kadriu

Prof. Ass.Dr. Majlinda Gjellaj, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit

Grupi punues:

Fadil Latifi, mësime të klasor

Fatbardha Zogaj-Reka, mësime të matemaikës

Shpetim Kastrati: mësime të shkencave të natyrës

Koordinuar nga:

Rrezearta Zhinipotoku-Behluli, GIZ

Dizajni dhe faqesja nga:

Envinion

Foto:

GIZ Kosova

Prishtinë, Dhjetor 2020

Tabela e përmbajtjes

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT: VLERËSIMI PËRMBLEDHËS – HARTIMI I TESTIT	5
Synimi i përgjithshëm i programit të trajnimit:.....	5
Qëllimet e Programit:.....	5
Grupi i synuar	5
HYRJE	6
PROFILI I KOMPETENCAVE TË MËSIMDHËNËSVE	7
VLERËSIMI I BAZUAR NË KORNIZËN E KURRIKULËS SË KOSOVËS	10
ROLI I VLERËSIMIT PËRMBLEDHËS NË PROCESIN E MËSIMDHËNIES DHE TË NXËNIT DHE LLOJET E VLERËSIMEVE TË NXËNËSVE	17
Çfarë është vlerësimi?	17
Format kryesore të vlerësimit	17
Llojet e vlerësimit:	18
VLERËSIMI FORMATIV	19
VLERËSIMI PËRMBLEDHËS (SUMATIV)	20
Parimet kryesore të vlerësimit.....	22
HARTIMI I TESTIT PËRMBLEDHËS.....	23
Nivelet e të nxënitorit sipas Taksonomisës së Bloom-it.....	23
Nivelet sipas taksonomisës së Bloom-it me shembuj të pyetjeve/ kërkesave të testeve të ndryshme.....	26
Hapat e ndërtimit të një testi.....	27
Tabela e përmbajtjes së testit – tabela e specifikimeve.....	27
Përcaktimi i llojeve të pyetjeve	29
Rregulla bazë për të gjitha formatet e pyetjeve	29
Numri i mjaftueshëm i pyetjeve në një test.....	29
Llogaritja e kohës së testit.....	30
Pikët, notat dhe nivelet.....	30
Testet që janë pjesë të teksteve mësimore.....	31
LLOJET KRYESORE TË PYETJEVE DHE RREGULLAT E TË SHKRUARIT TË TYRE.....	32

Llojet kryesore të pyetjeve.....	32
Pyetjet me plotësim ose me përgjigje të shkurtëra.....	32
Pyetjet me alternativa.....	33
Pyetjet E vërtetë/E gabuar.....	34
Pyetjet me shoqërim.....	36
Pyetje me prezantim viziv/grafik	37
Pyetjet në formë të problemave. Rëndësia dhe metoda të zgjidhjes së tyre	37
Pyetjet ese ose pyetjet me fund të hapur.....	39
ANALIZË TESTI/PYETJESH.....	41
Analiza e pyetjeve.....	41
Rishikim Testi	42
Analiza e shpeshtësisë.....	42
Vështirësia e pyetjes.....	42
Diskriminimi i pyetjes.....	43
DOKUMENTIMI DHE RAPORTIMI I VLERËSIMIT TEK NXËNËSIT, PRINDËRIT DHE AKTERËT E TJERË.....	46
ANEKS 1 – MODELE TESTE PËR VLERËSIM PËRMBLEDHËS	47
Test nga lënda e matematikës- Klasa e I-rë.....	47
Test nga lënda Njeriu dhe natyra- Klasa e II-të.....	53
Test nga lënda Shoqëria dhe mjedisi- Klasa e III-të.....	57
Test nga lënda e matematikës-Klasa IV-të.....	60
Test nga lënda e fizikës- Klasa e VI-të	64
Test – Kimia 7	68
Test nga lënda e biologjisë- Klasa e XIII-të.....	71
Test nga lënda e kimisë – Klasa IX-të.....	74
Test tematik në matematikë	77

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT: VLERËSIMI PËRMBLEDHËS - HARTIMI I TESTIT

Synimi i përgjithshëm i programit të trajnimit:

Zhvillimi i kompetencave të mësimitdhënësve para dhe në shërbim, të klasave 1-12 për vlerësimin përmblendhës me fokus në hartimin e testit si një nga instrumentet më të shpeshta të vlerësimit përmblendhës.

Qëllimet e Programit:

Me përvetësimin e këtij programi, pjesëmarrësit mund të:

- Definojnë vlerësimin përmblendhës dhe rolin e tij;
- Dallojnë elementet themelore, llojet dhe format e vlerësimit përmblendhës;
- Krahasojnë vlerësimin përmblendhës me vlerësimin formues;
- Përdorin procedurat standarde të hartimit të një testi për vlerësim përmblendhës;
- Hartojnë teste vlerësuese duke dalluar nivelet sipas Taksonomisë së rishikuar të Blumit;
- Ndërtojnë strukturën e testit – tabelën e specifikimeve të testit;
- Shkruajnë lloje të ndryshme të pyetjeve sipas rregullave të përcaktuara;
- Realizojnë, për të njëjtën kërkesë/pyetje, kalimin nga një nivel taksonomie në një tjetër;
- Matin treguesit kryesorë të pyetjeve në përbërje të një testi përmblendhës;
- Bëjnë lidhjen ndërmjet rezultateve mësimore me kompetencat e përcaktuara për shkallë të kurrikulës dhe përcaktojnë metodën e vlerësimit;
- Planifikojnë vlerësimin përmblendhës bazuar në RNF dhe RNL të ndërlidhura me kompetencat sipas KK;
- Realizojnë një vlerësim të drejtë, të saktë dhe të besueshëm, transparent dhe të paanshëm;
- Zbatojnë vlerësimin përmblendhës si mjet për motivimin e nxënësve për të arritur kompetencat e synuara;
- Përdorin rezultatet e vlerësimit për të marrë vendime për nxënësit, metodologjinë e mësimitdhënies dhe kurrikulën;
- Raportojnë vlerësimin përmblendhës para nxënësve, prindërve dhe të akterë ve të tjerë ;

Grupi i synuar

Ky program i dedikohet mësimitdhënësve të klasave 1 deri 12, para shërbimit dhe në shërbim. Programi ka gjithsej 30 orë ose një kredi (ECTS).

HYRJE

Të nxënit paraqet ndryshim relativisht të qëndrueshëm të individit. Ky ndryshim i individit varet nga mënyra se si një idivid nxë dhe motivohet për të nxënë. Motivimi i nxënësve për të nxënë ka ndërlidhje të drejtëpërdrejtë me procesin e vlerësimit. Nxënësit mësojnë dhe ndryshohen në drejtimin që mësimdhënësi i dërgon. Me një fjalë, nxënësit mësojnë atë që mësimdhënësi vlerëson. Nëse një mësimdhënësi ka pritshmëri të ulëta për nxënësit dhe nuk vlerëson arritjet e tyre, nuk pritet që nxënësit e tij të tregojnë rezultate të larta.

Vlerësimi i nxënësve është pjesë e pandashme e procesit të mësimdhënies dhe të nxënit. Një mësimdhënësi i përkushtuar në punë dhe i sukseshëm me nxënësit e tij, patjetër, karakterizohet me aftësi të larta të vlerësimit të nxënësve. Një mësimdhënësi i cili vëzhgon me kujdes dhe njeh mirë nevojat, aftësitë, afinitetet, prirjet e talentet e nxënësve të tij din edhe të planifikojë mësimdhënien të sukseshme, din t'i përshtatet stileve të të nxënit të nxënësve të tij dhe ta bëjë mësimdhënien e tij unike për një klasë dhe për nxënës të caktuar.

Mësimdhënësit e sukseshëm, përdorin lloje të ndryshme të vlerësimit si për të përkrahur të nxënit ashtu edhe për të përmbledhur suksesin e përgjithshëm të angazhimit të nxënësve. Mësimdhënësit efektiv, motivojnë nxënësit e tyre përmes një vlerësimi të drejtë, transparent, të besueshëm dhe të vlefshëm.

Ata, poashtu përdorin vlerësimin e nxënësve për të reflektuar për mësimdhënien e tyre dhe për të ndryshuar atë në varësi të nevojave të nxënësve.

Ky doracak, synon që mësimdhënësit të pajisen me dituri, shkathhtësi e vlera në lidhje me procesin e vlerësimit të nxënësve duke u fokusuar në vlerësimin përmbledhës dhe përpilimin e testeve. Në këtë mënyrë, pritet që mësimdhënësit përmes këtij informacioni të përmbushin profilin e kompetencave të një mësimdhënësi efektiv përfshirë këtu kompetencën e pestë të mësimdhënësve, të vlerësimit të nxënësve.

PROFILI I KOMPETENCAVE TË MËSIMDHËNËSVE

MASHT-i ka përgatitur një profil të kompetencave të mësimitdhënësve, duke identifikuar ato kryesoret dhe duke i klasifikuar në disa kategori. Kompetencat e mësimitdhënësve ndërlidhen dhe kushtëzojnë njëra-tjetrën. Ky program i adreson kompetencat edhe nënkategoritë e tjera, por posaçërisht ka parasysh zhvillimin e kompetencave të vlerësimit, e cila ka ndërlidhje me shumicën e kompetencave të tjera por drejtëpërdrejtë lidhet me aftësitë e mësimitdhënësve për të planifikuar dhe zbatuar metodologjitë e mësimitdhënies dhe në të njëjtën linjë për të planifikuar dhe zbatuar vlerësimin objektiv dhe të drejtë të nxënësve.

Tabela 1. Profili i kompetencave të mësimitdhënësve, Standardi 5.

NR.	PIKAT E REFERIMIT	KOMPETENCA	SHËNIME
1	Vlerësimi për tënxënëdhe tënxënit	<p>Kupton qëllimet e vlerësimit tënxënësve.</p> <p>Analizon rezultatet e instrumenteve për vlerësim në klasë dhe jashtë saj për matjen e cilësisë dhe sasisë së arritjeve.</p> <p>Njeh dallimin mes vlerësimit përmbledhës (sumativ) dhe formativ. Përdorë rezultatet në të mirë të të mësuarit të nxënësve.</p>	<p>Mësimitdhënësit e kuptojnë qëllimin e vlerësimit në klasën e nëntë dhe në Maturë dhe dinë të analizojnë rezultatit e këtyre vlerësimeve të jashtme për të përmirësuar praktikën e tyre të mësimitdhënies.</p> <p>Mësimitdhënësit dinësi të analizojnë rezultatet e vlerësimit cilësor dhe sasior dhe të përmbledhin gjetjet në raportet dhe shënimet për nxënësit.</p>
2	Përdorimi i metodave të llojllojshme të vlerësimit	<p>Njeh dhe përdor një shumëllojshmëri metodash për vlerësim të nxënësve dhe për vlerësim përfundimtar.</p>	<p>Mësimitdhënësit e dinëse vlerësimi përfshin vëzhgimin e nxënësve gjatëpunës nëgrupe, vlerësimin e punës me projekte dhe shkathtësive tëpunës ekipore, vlerësimin e shkathtësive komunikuese etj.</p>
3	Përdorimi i proceseve vëzhguese	<p>Përveç provimit me gojëdhe shkrim aplikon testin edhe vëzhgimin e nxënësve gjatëpunës nëgrupe, vlerësimin e punës në projekte dhe shkathtësitë e punës ekipore, vlerësimin e shkathtësive tëkomunikimit dhe fusha tëtjera.</p>	<p>Mësimitdhënësit e dinë kur dhe si të vlerësojnë nxënësit përmes teknikave të vëzhgimit qoftë individualisht, në grup apo gjatë punës ekipore. Mësimitdhënësit mund të dallojnë zhurmën e punës nga zhurma e lojës gjatë lehtësimit të punës në grupe në një klasë të zhurmshme.</p>

NR.	PIKAT E REFERIMIT	KOMPETENCA	SHËNIME
4	Përdorimi i strategjive të llojllojshme vlerësuese	Ka njohuri të duhura për teknika të ndryshme të monitorimit dhe vlerësimit të nxënësve.	Mësimdhënësit njohin dhe dinë të përdorin rubrika për shënimin e pikëve, harta konceptesh, portfolio, teste me zgjedhje të shumëfishta, provime, anketa, prezantime me gojë, rishikime mes kolegëve, raporte me shkrim, studime të rasteve, zgjedhje të problemeve dhe vlerësime të performancës.
5	Përcjellja e vazhdueshme e kapacitetit të nxënësve	Monitoron nxënësve në vazhdimësi për të identifikuar nevojat, përparësitë, dobësitë, interesat e tyre dhe përparimin individual në të nxënësve.	Mësimdhënësit dinë dhe pse të fokusohen në sjelljen individuale të nxënësve për të vërejtur nevojat, përparësitë, dobësitë dhe interesat e nxënësve për të shërbyer gjatë hartimit të aktiviteteve mësimore me qëllim të avancimit të të nxënësve.
6	Respektimi i parimeve	Kupton parimet dhe standardet e vlerësimit dhe të monitorimit.	Mësimdhënësit e dinë 5 parimet e vlerësimit janë: <ol style="list-style-type: none"> Ofrimi i informatave kthyesë efektive për nxënësve; përfshirja aktive e nxënësve në procesin e të nxënësve; përshtatja e mësimdhënies duke marrë parasysh rezultatet e vlerësimit; Ndërgjegjësimi përkitazi me ndikimin e madh që vlerësimi ka në motivimin dhe vetëbesimin e nxënësve – që të dyja këto me shumë rëndësi për procesin e të nxënësve; nevoja që nxënësve të kenë mundësi të vlerësojnë veten dhe të kuptojnë mënyrën e përmirësimit.
7	Përdorimi i vlerësimit për të nxënësve (formativ)	Përmirëson në vazhdimësi mësimdhënien dhe mbështet procesin e të nxënësve, gjithnjë në bazë të rezultateve të vlerësimit.	Mësimdhënësit dinë të vlerësojnë duke përdorur së paku 4 strategji, dhe e dinë pse vlerësimi është i rëndësishëm jo vetëm për qëllim të vlerësimit përmbledhës të të nxënësve por edhe për të ofruar informata kthyesë për praktikën e tyre të mësimdhënies.

NR.	PIKAT E REFERIMIT	KOMPETENCA	SHËNIME
8	Dokumentimi	Vlerëson, mban shënime për raste konkrete dhe raporton për shkathtësitë, nevojat e nxënësve dhe për zhvillimin e tyre individual.	Mësimdhënësit dinë si të bëjnë regjistrimin e rezultateve të vlerësimit dhe e kuptojnë pse është e rëndësishme që ato të jenë të sakta dhe të formuluar si duhet në kontekstin përkatës si: të jenë në përputhje me politikat shtetërore për raportimin e suksesit të nxënësve; të saktëdhe të kuptueshme lehtë për prindërit bazuar në Kurrikulin Kombëtar; ofrimi i raporteve me prindërit e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, raporte këto që janë në përputhje me legjislacionin, udhëzimet dhe procedurat e caktuara në politikat që kanë të bëjnë me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore; reflektimi i rezultateve të pritshme të caktuara në kurrikulë, ofrimin e një përshkrimi të sjelljes së secilit nxënës.
9	Sigurimi i transparencës	Sigurohet që kriteret për kërkesat e të nxënësve dhe të vlerësimit të jenë transparente për nxënësit.	Mësimdhënësit implementojnë strategji të vlerësimit që bëjnë të mundur që nxënësit të dinë çfarë të presin dhe për çfarë dhe pse vlerësohen .
10	Vlerësimi i proceseve	Vlerëson jo vetëm rezultatet, por edhe procesin e tënxënësve.	Mësimdhënësit dinëpse dhe si të vlerësojnë procesin e tënxënësve përveç rezultatit të tënxënësve. Mësimdhënësit din si të shfrytëzojnë teoritë e tënxënësve për të vlerësuar proceset kognitive dhe bihejvioriste tënxënësve. Mësimdhënësit din si të ndërveprojnë me nxënësit për të kuptuar dhe vlerësuar të menduarit e tyre gjatë zgjidhjes së një problemi apo gjatë procesit të arritjes në një përfundim e pastaj edhe për të raportuar këtë vlerësim.

VLERËSIMI I BAZUAR NË KORNIZËN E KURRIKULËS SË KOSOVËS

Në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës prezantohet një qasje e re prej asaj që ishte promovuar disa vite më herët në arsimin tonë, ku fokusi tash është në zhvillimin e kompetencave e jo në objektivat e të nxënësve si më parë. Rrjedhimisht, ndryshon i tërë procesi i mësimdhënies dhe të nxënësve dhe po ashtu ndryshon procesi i vlerësimit dhe i asaj çfarë dhe përse vlerësojmë.

Vlerësimi i bazuar në kompetencë, në vete përmban informata të hollësishme kthyesë të sakta dhe kritike, përmbajtjesore e konstruktive për të ndihmuar dhe motivuar nxënësve në arritjen e rezultateve të të nxënësve të cilat ndihmojnë në zotërimin e kompetencave.

Vlerësimi i bazuar në kompetencë është një proces kompleks dhe shumë dimensional i mbledhjes së informacioneve të referuara në:

- Qëllimet e arsimit parauniversitar,
- Parimet e arsimit parauniversitar,
- Kompetencat e Kurrikulës dhe
- Rezultatet e të nxënësve për shkallë dhe për fushë/lëndë

Qëllimet e arsimit parauniversitar

Në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar parashihet që qëllimet e arsimit të rinjtë/ të rejt të arrihen nëpërmjet zhvillimit të dijeve, të shkathësisë, të qëndrimeve dhe të vlerave që i kërkon shoqëria demokratike. Kjo u mundëson të rinjtë të jenë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm, të përballesh në mënyrë konstruktive me dallimet dhe sfidat si dhe të respektojnë të drejtat e tyre dhe të drejtat e të tjerëve.

Në këtë kontekst, qëllimet e arsimit janë:

- kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore
- promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare
- zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit
- aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore
- zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë për zhvillim të qëndrueshëm
- aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës. (MASHT, 2016)

Planifikimi i vlerësimit të nxënësve duhet t'i referohet në vazhdimsi qëllimeve të mësipërme të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës. Cdo hap i mësimdhënies dhe të nxënësve deri tek vlerësimi formativ dhe përmbledhës vëmendjen duhet ta ketë tek këto qëllime finale të arsimit parauniversitar.

Parimet e arsimit parauniversitar

Parimet për zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës Kurrikulare janë:

- Gjithëpërfshirja
- Zhvillimi i kompetencave
- Mësimdhënia dhe të nxëniet e integruar dhe koherent/të ndërlidhur
- Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkolle
- Përgjegjësia dhe llogaridhënia (MASHT,2016).

Zbatimi i KKK në vete përfshinë edhe vlerësimin e vazhdueshëm (formative dhe përmbledhës) i cili duhet të jetë koherent me këto parime. Planifikimi i vlerësimit referencë bazike ka këto parime.

Kompetencat kryesore sipas KKK

Kompetencat përfshijnë një sistem të integruar dhe koherent të dijeve, të shkathtësive dhe të qëndrimeve të aplikueshme dhe të transferueshme, të cilat do t'u ndihmojnë nxënësve që të ballafaqohen me sfidat e epokës digjitale, të ekonomisë së tregut të lirë dhe të bazuar në dije, në një botë të marrëdhënies të ndërvarura.

Organizimi i vlerësimit i bazuar në kompetenca përqendrohet në atë se çka nxënësit dinë, bëjnë dhe janë në gjendje të bëjnë dhe poashtu çfarë qëndrimesh dhe vlerash kanë krijuar.

Për të zotëruar një kompetencë, nxënësit duhet të kenë: njohuri, aftësi, zotësi, shkathtësi, qëndrim dhe vlera të cilat i justifikojnëpërmes rezultateve tëtënxëniet për fushë, shkallë, klasëdhe orë mësimore. Nxënësit i zotërojnë kompetencat nëse mësimdhënësit planifikojnë zotërimin e tyre, zbatojnë metodologji adekuate të mësimdhënies dhe i vlerësojnë ato.

Për t'i kuptuar më mirë më poshtë janë shkoqitur pjesët përbërëse të kompetencës.

Njohuria: është tërësia e fakteve, parimeve dhe informacioneve që zotërohen.

- terminologjia, simbolet, konceptet, metodat, parimet, kodet, faktet, idetë/

Aftësia: është fuqia, cilësia qëzotëron individi për ta përmbytur një veprim në mënyrë të suksesshme, brenda një kohe tëcaktuar.

- /identifikim, përshkrim, formulim, arsyetim, zbatim, vërtetim, analizë, sintezë, vlerësim, krijim/

Zotësia: është mundësia që ka individi për të arritur një nivel të caktuar të aftësisë.

- / mesatare, të lartë, me kufizime, i pa varur/

Shkathtësia: është mënyra e veprimit që kryhet pas një përsëritje a ushtrim.

- /matje, ndërtime, skicime, zgjidhje, përdorim burimesh, përdorim informacionesh, përdorim të teknologjisë, lexim të modeleve, krijim të modeleve të ndryshme/

Shprehia: është mënyra e veprimit a e sjelljes që kryhet vetvetiu pas një përsëritje a ushtrimi të gjatë

e të vazhdueshëm.

- /ushtrime, kurioziteti, fokusim në probleme, marrje e iniciativave/

Qëndrimi: është prirja për të reaguar në mënyrë specifike përkundrejt një situatë ose vlere, zakonisht e shoqëruar me ndjenja dhe emocione.

- /pjesëmarrje në diskutim, bashkëpunim, kërkim ndihme, dhënie ndihme, verifikim, kritika konstruktive/

Vlera: është kriter sipas të cilës gjykohet sjellja e individit në raport me grupin

- /respektimi i mendimit të tjetrit, marrje e përgjegjësi, vëmendje, demonstrim vullneti, respektim i rregullave, përmbushje e detyrave/

Kompetencat kryesore sipas kurrikulës re të Kosovës:

- 1 Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
- 2 Kompetenca e të menduarit
- 3 Kompetenca e të mësuarit
- 4 Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis
- 5 Kompetenca personale
- 6 Kompetenca qytetare

Cdo vlerësim i arritjes së rezultateve të të nxënës duhet të sigurojë ndërlidhje e cila kontribuon arritjes së kompetencave të më sipërme. Planifikimi i vlerësimit formativ dhe përmbledhës në fokus duhet të ketë zhvillimin e këtyre kompetencave.

Rezultatet e të nxënës

Rezultatet e të nxënës janë deklaratat që përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijnë, të besojnë, të vlerësojnë dhe të jenë në gjendje të bëjnë nxënës. Rezultatet janë shprehur në kornizën e kurrikulës në një varg domenesh, përfshirë dijen, të kuptuarit, shkathtësitë dhe kompetencat, vlerat dhe qëndrimet (MASHT, 2016). Bazuar në KKK, rezultatet e të nxënës janë të përcaktuara dhe të ndara në rezultate për kompetenca për secilën shkallë dhe rezultate për fushë ose lëndë janë përcaktuar në kurrikulat lëndore për secilën klasë. Nisur nga këto rezultate për cdo fushë dhe rezultatet e lëndës për secilën klasë, mësimdhënësit duhet të planifikojnë rezultatet të të nxënës për cdo orë mësimore si dhe të planifikojnë edhe kriteret e suksesit dhe mënyrën e vlerësimit.

Kriteret e suksesit

Kriteret e suksesit paraqesin kërkesa ose detyra konkrete çfare duhet të bëjnë nxënës hap pas hapi që të vërtetohet/tregohet nëse janë arritur dhe sa janë arritur rezultatet e të nxënës. Pra fokusi këtu bie tek procesi i cili tëqon drejt produktit final. Derisa, qëllimet e të nxënës (rezultatet) shërbejnë për të kuptuar se ‘çfarë’ dhe ‘pse’ po mësojmë kriteret e suksesit shërbejnë për të kuptuar se ‘si do ta dime nëse e kemi mësuar mësimin apo kemi qenë të suksesshëm?’. E rëndësishme është se, kriteret

e suksesit i japin përgjigje të njëjtës pyetje edhe nga këndvështrimi i nxënësit: Si do ta di nëse i kam realizuar qëllimet e të nxënësit?(BEP,2013).

Kriteret e suksesit e lehtësojnë vlerësimin e rezultateve të planifikuara sepse edhe nxënësi edhe mësimitdhënësi e din çfarë pritet të bëjë nxënësi për të arritur rezultatin.

Më poshtë janë dhënë disa shembuj të kriterëve të suksesit të ndërlidhura me rezultatet e të nxënësit dhe po ashtu mënyra e vlerësimit.

REZULTATI 1: KRIJON NJË MODEL TË PIRAMIDËS USHQIMORE.

Kriter i suksesit: Puno në kartuq piramidën ushqimore duke përdorur ngjyra të caktuara për secilin nivel nga baza deri tek maja e piramidës. Preje me gërshtërdhe ngjite në mur. Shkruaj emrin tënd.

Dmth. Secili nxënës e ka të qartë çfarë pritet nga ai/a jo për të konsideruar se është arritur rezultati i paraparë. Vlerësimi i kësaj detyre mund të bëhet përmes vlerësimit të ndërsjellë ku nxënësit shkruajnë në një listë emrin e shokut që e ka kryer detyrën dhe një+ ose – pranë emrit, varësisht a është kryer detyra.

REZULTATI 2: DALLON (VEPRIMI) QELIZËN SHTAZORE PREJ ASAJ BIMORE (KUSHTI) DUKE MARRË SË PAKU TRE SHEMBUJ (KRITERI).

Kriteri i suksesit: Rretho me ngjyrë të verdhë së paku tri qeliza shtazore dhe tri qeliza bimore me ngjyrë të gjelbër në ilustrimin e dhënë.

Vlerësimi: Nëse nxënësi ka dalluar 1-2 qeliza saktësisht merr 2 pikë, nëse nxënësi ka arritur të dallojë saktësisht 3-4 qeliza atëherë merr 4 pikë dhe nëse ka dalluar 5-6 qeliza, merr 6 pikë. Këto kriteret janë të ditura për nxënësit dhe ata mund vetë të vlerësojnë veten ose edhe shokun/shoqen.

Vërejtje: Ka raste kur mësimitdhënësit arrijnë që të shkruajnë rezultate ku përfshihet qëllimi, kushti dhe kriteri, atëherë nuk paraqitet nevoja e shkrimit të kriterëve të suksesit si të ndara. Megjithatë, më tepër preferohet që të shkruhen të ndara dhe konkrete për shkak të lehtësimit të vlerësimit por edhe orientimit më të mirë të nxënësve se çfarë duhet të bëjnë. Ndonjëherë mund të shkruani më shumë se një kriter për një rezultat të të nxënësit por nuk mund të lini rezultatin pa asnjë kriter.

REZULTATI 3: TREGON POROSINË E PËRRALLËS DHE RËNDËSINË E SAJ NË JETËN E PËRDITSHME.

Kriteri i suksesit 1: Shkruaj së paku një paragraf me së paku 5 rreshta që tregon porosinë kryesore të përrallës. (deri në 5 pikë)

Kriteri i suksesit 2: Shkruaj së paku 3 rreshta për rëndësinë e kësaj porosie në jetën e përditshme. (deri në 5 pikë)

Vlerësimi: Detyrën e shkruar në fletë nxënësit e dorëzojnë tek mësimmshënësi ndërsa ai jep pikët sipas kriterit të suksesit. Nxënësit mund të bëjnë edhe vetëvlerësim ose vlerësim të ndërsjellë sipas kriterit të përcaktuar.

REZULTATI 4: PËRDOR SAKTË SHENJAT E PIKËSIMIT - , ? , !.

Kriteret e suksesit: Vendos shenjat përkatëse të pikëzimit në fund të fjalive të dhëna. Shkruaj në kllapa, llojin e fjalisë).

Sqarim: Nëse janë dhënë 6 fjali, vendosim 6 pikë për këtë detyrë sepse e kemi të lehtë të vlerësojmë. Aq shenja të sakta në vendin e duhur, aq pike merr nxënësi. Kështu ata lehtësisht mund ta vlerësojnë veten ose shokun/shoqen.

REZULTATI 5: KRIJON NJË HISTORI VETËM NGA TITULLI PARA SE TË LEXOHE TREGIMI

Kriteri i suksesit: Shkruaj një histori sipas titullit të tregimit ende pa e lexuar atë. Përdor të gjitha fjalët kyce që janë në titull. Vizato personazhin kryesor.

Vlerësimi: Kontrollim i detyrës sipas kriterëve të përcaktuara.

REZULTATI 6: MODELON VIJË TË HAPURA DHE TË MBYLLURA ME MATERIALE TË NDRYSHME

Kriteri i suksesit: -Puno një vijë të hapur dhe një vijë të mbyllur duke përdorur materialin që ke në dispozicion (fije leshi, tel i hollë, shpageta). Ngjit punimin në mur.

Vlerësimi: Vëzhgim, informatë kthyese.

REZULTATI 7 (RFN): ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE TË KOMUNIKIMIT NË SHKENCË DHE PËRMES SHKENCËS.

Kriteri i suksesit: Zgjedh një dukuri/ fenomen shkencor nga lënda e fizikës, kimisë apo biologjisë.

Hulumto për të gjitha faktet që mund të gjesh nga burime të ndryshme të informatës (libra, ekspertë, internet).

Përgatit një prezantim në PPT. Prezantimi duhet të ketë së paku 15 sllajde. Prezanto para klases. (gjithsej 40 pikë).

Vlerësimi: Vlerësim i projektit sipas kriterëve të përcaktuara (40 pikët ndahen për hapat e caktuar të përfundimit të projektit hulumtues dhe ato duhet të jenë transparente për nxënësit).

Lidhja e rezultateve të të nxënit për kompetenca me rezultatet e të nxënit për fushë/lëndë dhe vlerësimi i arritjes së tyre

Procesi i mësimdhënies ndërlidhet me një varg kërkesash, parimesh e treguesish të cilat dalin nga dokumenti i Kornizës së Kurrikulës së Kosovës. Ajo çfarë presim nga nxënësit tanë pasi të arrijnë moshën 18-të vjeçare, është e përcaktuar në këtë dokument. Koherenca ndërmjet këtyre kërkesave dhe procesit të mësimdhënies dhe vlerësimit përcakton suksesin e domosdoshëm.

Një mësimdhënës, derisa planifikon orën mësimore për një lëndë të caktuar duhet të mendojë: Cfarë kontribon kjo orë mësimore në: arritjen e qëllimeve të kurrikulës, respektimin e parimeve të kurrikulës, arritjen e kompetencave, arritjen e rezultateve të të nxënit të përcaktuara për fushën përkatëse dhe për shkallën e caktuar dhe si do ta vlerësoj nivelin e realizimit të këtyre kërkesave ligjore e përmbajtësore.

Këtë e bën më së miri nëse rezultatet e të nxënit për orën mësimore i shkruan duke i ndërlidhur me rezultatet për kompetenca, rezultatet e tënxënëit për fushën dhe lëndën përkatëse dhe nëse planifikon kriteret e vlerësimit dhe një ose më shumë metoda të vlerësimit të nxënësve që masin realizimin e këtyre kriterëve.

**SHEMBULL:****Klasa:** IX-të**Lënda:** Matematikë**Tema:** Përpjestimi (proporcioni), përqindja, promili dhe kamata.**Njësia mësimore:** Përqindja**Kompetencat:**

- të bëjnë zgjidhjen e problemeve në nivelin e caktuar të vështirësisë;
- të mësojnë duke shfrytëzuar teknologjinë elektronike;
- të bashkëpunojnë me të tjerët, në procesin e të nxënit;

Rezultati i të nxënit për lëndë (RNL): Përdor formulat për llogaritjen e përqindjes, promilit dhe kamatës për zgjidhje të problemeve me kontekste nga situata jetësore;

Rezultatet e tënxënit:

- 1 Përcakton përqindjen e një sasi të një sasi tjetër.
- 2 Gjen përqindjen e rritjes së cmimit
- 3 Gjen përqindjen e zvogëlimit të cmimit
- 4 Zbaton formulën për llogaritjen e përqindjes për zgjidhjen e problemeve në situata jetësore.

Kriteret e vlerësimit:

- 1 Në bashkëpunim me shokun/ shoqen e bankës zgjidhni detyrën 1 dhe 2 duke përdorur formulën e përqindjes dhe shkruani vërtetimet (2 pikë)
- 2 Shkruaj një rast të rritjes së cmimit të një këmishe dhe gjej përqindjen e rritjes. (4 pikë)
- 3 Shkruaj një rast të uljes së cmimit të një makine dhe gjej përqindjen e uljes përmes përdorimit të digitronit. (4 pikë)
- 4 Ke shkuar me shoket për të parë një film në kinema dhe 75% e ulëseve janë zënë. Ju e dini se në atë sallë janë 300 ulëse. Duke përdorur formulën e përqindjeve, gjej edhe sa ulëse kanë mbetur të lira. Hijëzo me laps 75% të ulëseve në fotografimin dhënë. (10 pikë)

Vlerësimi: Kontrollimi i detyrave me shkrim dhe pikëzimi sipas kriterëve.

ROLI I VLERËSIMIT PËRMBLEDHËS NË PROCESIN E MËSIMDHËNIES DHE TË NXËNIT DHE LLOJET E VLERËSIMEVE TË NXËNËSVE

Çfarë është vlerësimi?

Vlerësimi është çdo metodë sistematike e marrjes së informacionit, e përdorur për të nxjerrë konkluzione në lidhje me karakteristikat e njerëzve, objekteve ose programeve “(Shoqata Kërkimore Arsimore Amerikane [AERA], Shoqata Psikologjike Amerikane [APA] dhe Këshilli Kombëtar për Matjen në Arsim [NCME], 1999, fq 172). Kështu, në arsim, vlerësimi mund të përfshijë procedura të ndryshme për zgjedhjen e provave të aftësive dhe njohurive të studentëve, nga testimet në mbarë vendin, deri tek metodat jofor-male të mësuesve për të zbuluar se çfarë kanë mësuar dhe çfarë janë në gjendje të bëjnë studentët e tyre.

Vlerësimi mund të përqendrohet në arritjen ose nevojat mësimore të individëve, ose mund të sigurojë të dhëna për grupet e kategorizuara nga klasa, shkolla, shteti, kombi, gjinia, përkatësia etnike, gjuha, aftësia e kufizuar, niveli i të ardhurave familjare, etj. (Odendahl,2010). Sipas UA nr 08/2016 për vlerësimin e nxënësve bazuar në Kornizën e Kurrikulës së arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës, vlerësimi ka për qëllim mbledhjen e informacioneve **për përkrahjen e nxënësit** në zotërimin e rezultateve të tënxënësve, përcaktimin e nivelit të performancës, raportimin e rregullt të progresit, certifikimin dhe orientimin në shkollim të mëtejshëm. Po sipas këtij udhëzimi, nxënësit vlerësohen përmes vlerësimit të vazhdueshëm, formativ dhe përmbledhës.

Pa praktikatat e shëndosha të vlerësimit, ne nuk mund të dime nëse nxënësit po ecin sipas planit. Për më shumë, ne nuk mund të jemi në gjendje të planifikojmë në mënyrë efektive mundësitë e mësimit të nxënësve në të ardhmen.

Format kryesore të vlerësimit

Vlerësimi mund të shërbejë për qëllime të ndryshme dhe forma që ju zgjidhni do të varet nga qëllimi i tij. Një nga qëllimet kryesore të vlerësimit, i shprehur qartë edhe në Kornizën Kurrikulare të Kosovës, është motivimi i nxënësve dhe planifikimi i veprimtarive për përmirësimin e rezultateve në të ardhmen. Korniza Kurrikulare përcakton tri lloje të vlerësimit të brendshëm:

- Vlerësimi i vazhdueshëm
- Vlerësimi përfundimtar
- Vlerësimi për shkallë

Vlerësimi i vazhdueshëm realizohet nëpërmjet vlerësimit formativ ndryshe i njohur si vlerësim për të nxënës dhe është pjesë e mësimdhënies sikurse edhe vlerësimit përmbledhës i cili realizohet për tri periudha mësimore, për: Shtator- Dhjetor, Janar- Mars dhe Prill- Qershor. Brenda secilës periudhë, për klasat 6-12, realizohen nga dy vlerësime përmbledhëse (VP1 dhe VP2), ndërsa për klasat 1 deri 5 nxënësit vlerësohen në të tri periudhat vetëm me një vlerësim përmbledhës (VP1) i cili është i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit dhe brenda të cilit përdoren forma dhe lloje të ndryshme të vlerësimit, formues dhe përmbledhës (sipas nevojës edhe diagnostikues).

VLERËSIMI FORMATIV

Quhet ndryshe edhe vlerësim për të nxënë (VpN). Karakteristikat, qëllimi dhe format e zbatimit janë të shprehura në dokumentin e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës dhe dokumente tjera më specifike të lidhura me vlerësimin të MASHT. Në këtu po e prezantojmë shkurt, pasi qëllimi ynë kryesor nëpërmjet këtij materiali është thellimi në vlerësimin përmbledhës.

Vlerësimi formativ është projektuar për të ndihmuar nxënësit të mësojnë në mënyrë më efektive duke u dhënë atyre tregues dhe drejtime si mund të përmirësohen. Fokuset në dhënien e komenteve konstruktive të cilat ndihmojnë nxënësin të reflektojë për punën e tij dhe të planifikojë hapat e mëtejme me synim të përmirësimit të rezultateve të të nxënësit, të cilat pas një kohe mund të maten me anë të vlerësimit përmbledhës ose sumativ. Një vlerësim formues për shembull, mund të marrë formën e një testi në klasë që është vlerësuar nga mësimitdhënësit, shoku apo vete nxënësi, por nuk është vendosur notë.

Format e vlerësimit formativ:

- Vëzhgimi i nxënësve dhe mbajtja e shënimeve gjatë orëve të mësimimit
- Detyrat e shtëpisë dhe rishikimi e diskutimi i tyre në klasë.
- Dhënia e informatave kthyes/ feed-back.
- Pyetje-përgjigjet e planifikuara dhe spontane në mësim
- Bashkëbisedimi dhe ndërveprimi mësues-nxënë sipas periudhave
- Aktiviteti i nxënësit në klasë kur raporton rezultate të punëve individuale dhe në grup
- Vlerësimi i ndërsjellë i nxënësve
- Vetëvlerësimi.
- Portofolio e nxënësit.

VLERËSIMI PËRMBLEDHËS (SUMATIV)

Përdoret për të treguar shkallën e suksesit të nxënësit në përmbushjen e rezultateve të të mësuarit për një njësi/kapitull të programit dhe për një periudhë të caktuar kohore. Një vlerësim përmbledhës përcakton notën që merr apo nivelin që arrin nxënësi në përvetësimin e rezultateve të planifikuara për klasën apo periudhën përkatëse.

Vlerësimi duhet të jetë pjesë përbërëse e planeve vjetore, planeve mujore dhe ditore të mësimdhënësve. Mësimdhënësit duhet ta planifikojnë vlerësimin përmbledhës (vlerësimin e të nxënësve) në përputhje me rezultatet e pritshme të caktuara në kurrikulë.

Vlerësimi përmbledhës kryhet në fund të procesit të të nxënësve dhe jep informata kthyesë për të mësuarit të shprehur në sasi (përqindje, notë). Vlerësimi përmbledhës është më shumë i shprehur si produkt dhe vlerëson produktin final, ndërsa vlerësimi formues është procesi që çon në finalizimin e produktit.

E rëndësishme është që mësimdhënësit të kenë parasysh që të dy llojet e vlerësimit (formues dhe përmbledhës) e kanë rolin dhe rëndësinë e vetë dhe se njëri nuk zëvendëson tjetrin. Vlerësimi përmbledhës nuk identifikohet me vlerësimin tradicional, ashtu sic nuk identifikohet vlerësimi formues me vlerësimin bashkëkohor.

Format e vlerësimit përmbledhës

Varësisht nga qëllimi i vlerësimit ose rezultatet e planifikuara të nxënësve mësimdhënësit mund të përdorin për vlerësimin përmbledhës, një ose më shumë nga format e vlerësimit të renditura më poshtë. Këto forma të vlerësimit mund të quhen përmbledhëse nëse janë të shprehura me pikë, përqindje ose notë:

- Detyrat e ndryshme të përditshme.
- Të shprehurit me gojë dhe aktivizimi në mësim.
- Projektet e ndryshme tematike
- Dosja e nxënësve.
- Eset.
- Teste për (njësi/ kapituj/gjysmëvjetorë/)
- Teste përfundimtare
- Teste përmblylëse

Bazuar në Udhëzimin Administrativ 08/2016 për vlerësimin e nxënësve, vlerësimi përmbledhës bëhet dy here gjatë një periudhe mësimore. Ai është i ndarë në Vlerësimin Përmbledhës 1 (VP1) që përfshinë 60% të vlerësimit dhe Vlerësimin Përmbledhës 2 (VP2) i cili përfshinë 40% të vlerësimit të një periudhe mësimore psh. Periudha 1 përfshinë muajt: shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor dhe është periudha më e gjatë. Brenda kësaj periudhe mësimdhënësit përcjellin dhe vlerësojnë nxënësve në forma të ndryshme duke përdorur dhe vlerësimin formues me komente e informata kthyesë të cilat duhet të jenë përshkruese, të sakta dhe e fokusuara e specifike e jo të përgjithësuara, duhet

të jenë gjithashtu të matura, të individualizuar dhe me orientim pozitiv për nxënësin dhe t'i japë mundësi nxënësit të reagojë (BEP,2013).

Mësimdhënësit mbajnë shënime në mënyrë të vazhdueshme në ditarin e tyre personal për secilin nxënës duke regjistruar të gjitha aktivitetet dhe përpjekjet e nxënësit përmes detyrave, eseve, projekteve, performancës me gojë me shkrim, vizatimeve, prezantimeve etj dhe të gjitha këto i përmbledhin në 60% të vlerësimit dhe zgjedhin një instrument të caktuar, varësisht nga lënda dhe nëbashkëpunim me mësimdhënësit e tjerë, për të mos i ngarkuar nxënësit me të njëjtën mënyrë të vlerësimit të dytë përmbledhës i cili përfshinë edhe 40% të vlerësimit të një periudhe mësimore (Tabela 2 dhe 3.) Për realizimin e vlerësimit përmbledhës VP2, aktivitetet profesionale përcaktojnë planin e vlerësimit për të mos i ngarkuar nxënësit (p.sh, të gjitha lëndët test ose ese). Nxënësit e klasave 1 deri 5 vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme (lloje të ndryshme të vlerësimit formues) dhe vetëm përmes vlerësimit përmbledhës 1 (VP1) në cdo periudhë.

Nxënësit e klasave parafillore, klasës së parë dhe të dytë vlerësohen vetëm në mënyrë përshkruese.

Tabela 3. Planifikimi i vlerësimit të vazhdueshëm sipas llojeve të vlerësimit

VITI SHKOLLOR- VLERËSIMI I BRENDSHËM VAZHDUESHËM					
Vlerësimi përmbledhës DHJETOR		Vlerësimi përmbledhës MARS		Vlerësimi përmbledhës MAJ-QERSHOR	
VP1 60%	VP2 40%	VP1 60%	VP2 40%	VP1 60%	VP2 40%
-Detyrat e ndryshme të përditshme të shprehurit me gojë dhe aktivizimi në mësim	Një teknikë e vlerësimit përmbledhës P.SH. TEST (varësisht nga lënda, varësisht nga RNL,	-Detyrat e ndryshme të përditshme -Të shprehurit me gojë dhe aktivizimi në mësim	Një teknikë e vlerësimit përmbledhës P.SH. ESE (varësisht nga lënda, varësisht nga RNL,	-Detyrat e ndryshme të përditshme -Të shprehurit me gojë dhe aktivizimi në mësim	Një teknikë e vlerësimit përmbledhës P.SH. PROJEKT (varësisht nga lënda, varësisht nga RNL,
-Projektet e ndryshme tematike Dosja e nxënësit, etj.	varësisht nga kompetenca/t qëka/kanë qenë synim)	-Projektet e ndryshme tematike -Dosja e nxënësit, etj.	varësisht nga kompetenca/t qëka/kanë qenë synim)	-Projektet e ndryshme tematike -Dosja e nxënësit etj.	varësisht nga kompetenca/t qëka/kanë qenë synim)
Nota 1-5		Nota 1-5		Nota 1-5	
NOTA PËRFUNDIMTARE E VITIT SHKOLLOR- mesatarja aritmetike e notave në të tri periudhat					

Shkolla duhet të ketë një sistem për të verifikuar dhe për të siguruar cilësi në kryerjen e vlerësimit përmbledhës. Si pjesë e planit zhvillimor, shkollat duhet të zhvillojnë dhe implementojnë një sistem për verifikim të brendshëm të vlerësimit, me role të përcaktuara dhe personel të kualifikuar. Ky sistem kontrollon instrumentet vlerësuese sipas standardeve, kritereve dhe kontrollon kushtet e procedurat për administrim. E rëndësishme në këtë proces është bashkëpunimi midis kolegëve dhe aktiveve profesionale. Planifikimi i vlerësimit përmbledhës në klasat 6 deri 12 nuk është qështje individuale e mësimdhënëseve.

Parimet kryesore të vlerësimit

Në mënyrë të përgjithshme vlerësimi i nxënësve duhet:

- të respektojë personalitetin e nxënësit,
- të nxisë vetëbesimin e nxënësit dhe ndjenjën për përparim,
- të nxitë nxënësin të verifikojë dijen e tij,
- të aftësojë nxënësin për mësim të pavarur për vetëvlerësim dhe vlerësim të të tjerëve.

Vlerësimi efektiv varet kryesisht nga këto parime:

- vlefshmëria,
- transparenca
- besueshmëria,
- paanshmëria

Vlefshmëria tregon nëse vlerësimi mat atë që ka planifikuar, nëse është në përputhje me rezultatet e të nxënësve dhe në përpjesëtim me vëllimin e caktuar tënjohurive. Në kurrikulën bërthamë ndër të tjera thuhet: "... për lëndët e fushës së edukimit shëndetësor për shkak tëspecifikimeve qëka do të ishte e vlefshme që përveç vlerësimit numerik të aplikohet në masë të madhe vlerësimi përshkruar pasi që puna në grup, projektet, aftësitë motorike, aftësia e të folurit, etj. nuk mund të maten me anë të testeve. Për t'i matur dhe për t'i vlerësuar ato përdoren instrumente të tjera. Vëzhgimi i drejtpërdrejtë është një procedure e përshtatshme për fushën e edukimit shëndetësor dhe që mund të përdoret në situata të ndryshme mësimore dhe në të gjitha nivelet e shkollimit." Një test nuk do të jetë i vlefshëm, p.sh. për të vlerësuar aftësitësi shofer/voztës. Një mënyrë më e vlefshme do të ishte kombinimi i testeve që ndihmojnë të përcaktoj nëse çfarë di dhe është në gjendje të bëjë praktikisht shoferi.

Transparenca. Vlerësimi duhet të sigurojë se kriteret, metodat dhe procedurat e vlerësimit janë të njohura për nxënës dhe për të gjithë akterët e përfshirë në procesin e vlerësimit. Informacioni për nxënësin, lidhur me rezultatet e arritura, informatat kthyesë dhe mundësitëe përparimit të jetë i qartë, i saktë dhe të jepet me kohë.

Besueshmëria ka të bëjë me vërtetësinë, qëndrueshmërinë në përsëritjen e vlerësimit/matjes. Besueshmëria na siguron se gjykimet janë të qëndrueshme dhe bazohen në një sistem të dhënash. Një komponent kyç i besueshmërisë është saktësia e vlerësimit me pike të përgjigjeve. Diskutoni dhe pajtoni qasjen tuaj me vlerësuesit e tjerë para se të filloni të vlerësoni. Miratoni kriteret e vlerësimit dhe përdorni të njëjtën skemë vlerësimi të strukturuar. Një skemë vlerësimi e strukturuar lejon/ mundëson vendosjen e një sasive të njëjtë pikësh për çdo pyetje të vlerësuar nga vlerësues të ndryshëm. Besueshmëria në disa raste varet shumë nga lënda mësimore. P.sh që një test në lëndën e histories të ketë besueshmëri të lartë, ka nevojë që të gjitha pyetjet të jenë objektive. Ndryshe ndodh në lëndën e matematikës, kjo mund të arrihet më lehtë edhe duke përdorur pyetje të llojeve të tjera.

Paanshmëria. Vlerësimi duhet të sigurojë se respektohen kërkesat e kodit etik tëvlerësimit, respektohen procedurat e vlerësimit ndaj çdo nxënësi apo grupi të nxënësve, përdoren instrumente të ndryshme të vlerësimit që i mundësojnë secilit nxënës të shfaqë performancën e tij/saj dhe ofrohet mbështetja e duhur në tënxënit e nxënësve drejt zotërimit të kompetencave.

HARTIMI I TESTIT PËRMBLEDHËS

Në këtë pjesë të doracakut do të flitet për testin si instrument i vlerësimit përmbledhës.

Testi është një instrument vlerësimi që përdoret për të matur njohuritë dhe aftësitë e nxënësve. Testi është formë vlerësimi më së shumti e njohur dhe e përdorur, kështu që duke pasur parasysh rëndësinë e një vlerësimi të saktë të të nxënësve, është shumë e rëndësishme të dihet se si hartohet një test i shkruar mirë dhe i vlefshëm.

Një nga hapat më të rëndësishëm në hartimin e një testi është që të merren parasysh rezultatet e të nxënësve dhe të përcaktohet se cilat aspekte duhet vlerësuar me këtë test. Pasi të identifikohen se cilat rezultate do të maten, duhet të merret parasysh se çfarë lloji i pyetjes më mirë mundëson reflektimin e nxënësve lidhur me atë rezultat. Për shembull, a është qëllimi për të krijuar një test që kërkon nga nxënësit që të japin përkufizime apo që nxënësit të demonstrojnë aftësinë e tyre për të krahasuar koncepte të ndryshme dhe të mbrojnë pozitën e tyre në një subjekt të diskutueshëm. Testi dhe të gjitha instrumentet e tjera të vlerësimit të nxënësve duhet të synojnë që të masin arritjen e kompetencave të cilat janë të konkretizuara përmes rezultateve të të nxënësve. Fokusi i vlerësimit duhet të bëhet motivimi i zhvillimit të mendimit kritik dhe kreativ dhe jo të ndalet tek të mbajturit mend dhe përsëritja e fakteve. Nxënësit orientojnë aktivitetin e tyre dhe përpjekjet për të nxënë, në drejtimin që mësimdhënësit e vënë fokusin gjatë vlerësimit. Pra nxënësit zakonisht mësojnë atë që mësimdhënësi pyet/ vlerëson. Deri sa mësojnë dhe përgatiten për një test, ata shpesh pyesin njëri-tjetrin: A na bie kjo në test?

Vetëm pyetjet e mira veç e veç nuk garantojnë medoemos që testi të jetë i mirë, pasi testi si një i tërë, është më shumë se një grupim i thjeshtë pyetjesh. Për këtë është me rëndësi që së pari të dihet se çka dëshirojmë të matim, cilin rezultat të të nxënësve dëshirojmë ta realizojmë, cilën kompetencë dëshirojmë ta arrijmë.

Në hartimin e një testi, rëndësi të veçantë ka përdorimi i Taksonomisë së Bloom-it, si një strukturë hierarkike e aftësive të të menduarit e cila përdoret për të planifikuar dhe vlerësuar arritjen e objektivave, synimeve ose rezultateve të të nxënësve.

Nivelet e të nxënësve sipas Taksonomisë së Bloom-it

Taksonomia e Bloom-it është një kornizë për kategorizimin e qëllimeve arsimore të quajtur Taksonomia e Objektivave Arsimore e cila u përdor nga mësimdhënësit parauniversitar dhe universitar për vite me rradhë edhe sinjë sistem për klasifikimin e kërkesave/ pyetjeve sipas nivelit të hierarkisë së dijes.

Taksonomia e Bloom-it është model shume-nivelor i klasifikimit të të menduarit bazuar në 6 nivele të kompleksitetit. Taksonomia është një mënyrë e klasifikimit të pyetjeve/kërkesave dhe ndihmon që të kemi lloje të ndryshme të pyetjeve sidomos gjatë përpilimit të rezultateve të të nxënësve dhe matjes/vlerësimit të tyre përmes testeve.

Figura 1. Taksonimia e Bloomit 1956 dhe e rishikuar më 2001



Në figurat më sipër janë paraqitur nivelet e Taksonomisë së Bloomit, e para në vitin 1956 e përpiluar nga Benjamin Bloom dhe një grup i psikologëve të edukimit ndërsa e dyta është taksonomia e rishikuar e Bloomit e cila u realizua nga studenti i tij, Lorin Anderson pas një pune 6 vjecare të cilën e finalizoi në vitin 2001. Vëreni se emrat janë shëndrruar në folje si veprime dhe kjo si përgjigje ndaj kërkesave të shekullit 21 ku prej nxënësve kërkohet të jenë në gjendje të bëjnë ose zbatojnë atë çfarë dinë dhe besojnë.

- **Të krijuarit** paraqet kategorinë më të lartë të menduarit dhe shpreh atë çfarë nxënësit mund të krijojnë, duke bërë lidhjen midis njohurive që kanë: A mundën nxënësit të krijojnë një produkt ose një këndvështrim? Të bashkojnë, ndërtojnë, krijojnë, hartojnë, zhvillojnë, formulojnë, shkruajnë dicka të re? P.sh. Nxënësi X që ka mësuar për emrin, mbiemrin, kallëzuesin etj. në lëndën e gjuhës shqipe, ka mësuar për ndikimin e ndotjes së ambientit në lëndën e shkencave natyrore dhe ka krijuar edhe qëndrim negativ ndaj ndotësve përmes lëximit dhe vëzhgimit të situatave reale tani arrinë të lidhë të gjitha këto në një ese.
- **Të vlerësuarit:** A mund që nxënësit të justifikojnë/arsyetojnë një qëndrim ose një vendim të tyre? Të vlerësojnë, argumentojnë, mbrojnë, gjykojnë, zgjedhin, mbështesin, cilësojnë.

P.sh. Nxënësi X gjykon dëmet që shkaktojnë fabrikat të cilat hedhin mbetjet e tyre në lumënjë.

- **Të analizuarit:** A mund që nxënësit të bëjnë dallimin midis dy pjesëve të ndryshme? Të krahasojnë, kontrastojnë, kritikojnë, dallojnë, përcaktojnë, ekzaminojnë, eksperimentojnë, pyetin, provojnë.

p.sh. Nxënësi X, krahason fabrikën X e cila hedh mbeturinat në lum me fabrikën Y e cila mbetjet e prodhimit i dërgon në riciklim.

- **Të zbatuarit:** A mund që nxënësit të përdorin infomatën në një mënyrë tjetër të re? Të bëjnë zgjedhje, të demonstrojnë, të vënë në përdorim, dramatizojnë, ilustruojnë, interpretojnë, veprojnë, planifikojnë, zgjidhin, përdorin, shkruajnë.

P.sh. Nxënësi X përpilon një plan me hapat e caktuar për të promovuar riciklimin e mbetjeve të prodhimtarisë në një fabrikë.

- **Të kuptuarit:** A mund që studentët të sqarojnë ide ose koncepte? Të klasifikojnë, shpjegojnë, diskutojnë, sqarojnë, identifikojnë, lokalizojnë, njohin, raportojnë, përzgjedhin, përkthjenëme fjalë të tjera, parafrazojnë.

P.sh. Nxënësi X shpjegon dëmet që shkakton hedhja e mbeturinave nga ana e fabrikës, në lum.

- **Të mbajturit mend:** A mund që studentët të definojnë, përsërisin, listojnë, memorizojnë, rikujtojnë ose mbajnë në mend një informacion? Të rikujtojnë, përsërisin, riprodikojnë etj.

P.sh. Nxënësi X shkruan ose thotë një definicion për riciklimin ose për ndotjen.

Në dokumentet e vlerësimit të MASHT, një model i tillë (Bloom, 1956) është paraqitur në mënyrë më të plotë dhe rekomanduar për hartimin e rezultateve të të nxënës dhe po ashtu në përpilimin e testeve. Megjithatë, në këtë doracak do të përpiqemi që përpilimi i testeve të bazohet në taksonominë rishikuar sepse nga nxënësit do të kërkojmë nivel më të lartë të të menduarit dhe kryesisht qëllimi do të jetë përgatitja e tyre për të zbatuar dhe përdorur në jetën e përditshme dijen, shkathësitë dhe qëndrimet e tyre.

Taksonomia duhet të përdoret si një udhëzues. Shpesh klasifikimi në një nivel të caktuar kërkon matje e vlerësime shtesë. Nganjëherë disa pyetje përmbajnë elemente të disa niveleve të taksonomisë. P.sh. një pyetje që kërkon analizë, brenda vetes përmbanë të mbajturit mend dhe të kuptuarit. Kjo do të thotë se nuk duhet të bëhemi skllëvër të sistemit të klasifikimit, që ajo të na pengojë, por ta përdorim klasifikimin për një vlerësim të efektshëm. **Gjithsesi, nëse qëllimi juaj ka qenë të zhillohet aftësia për të analizuar, gjykuar e krijuar dhe ju keni zhvilluar mësimdhënien në këtë drejtim, shtroni pyetje që kërkojnë analizë, gjykim dhe krijim por, nëse keni punuar në drejtim të zhvillimit të aftësive të të mbajturit mend dhe në test kërkonin zgjidhje problemash, nxënësit në test nuk do të dalin tësuksesshëm.**

NIVELET SIPAS TAKSONOMISË SË BLOOM-IT ME SHEMBUJ TË PYETJEVE/ KËRKESAVE TË TESTEVE TË NDRYSHME

Të krijuarit: Shkruaj një paragraf me së paku 5 rreshta në lidhje me efektet e përdorimit të narkotikëve në shëndetin e njeriut. Përdor fjalët kyce: substancë, abuzim, rrezik.

Të vlerësuarit:

Investimet në shëndetin e adoleshentëve, shkaktojnë efekt pozitiv pasi që:

- (A) Adoleshentët humbin kohë duke ndjekur programe shëndetësore dhe largohen nga organizimet rinore të dëmshme.
- (B) Adoleshentët kursejnë paratë e prindërve dhe shfrytzojnë buxhet institucional.
- (C) Investimi në adoleshentë sjell humbje ekonomike për të ardhmen e vendit dhe rrezikon përkujdesjen ndaj të moshuarve.
- (D) Sjell përfitime ekonomike, produktivitet të rritur, kthim të investimeve dhe kosto më të vogël në të ardhmen.

Të analizuarit:

Vëzhgo figurën e dhënë dhe rretho më ngjyrë të kaltër-kafshët, me ngjyrë të verdhë- shpezët dhe me ngjyrë të kuqe, bimët.

Të zbatuarit:

Oborri përpara një shtëpie do të shtrohet me katror betoni me brinjë $a=0.5m$. Oborri që do të shtrohet ka formë drejtkëndëshi me brinjë $a=11.8m$ dhe $b=8.5m$. Sa pllaka duhen për të shtruar këtë pjesë të oborrit?

Të kuptuarit:

Shembull . Shkruani me simbole matematike: „Shuma e syprinave të sipërfaqeve katrore të ndërtuara mbi katetet a dhe b është e barabartë me syprinën e sipërfaqes katrore të ndërtuar mbi hipotenuzë”?

Të mbajturit mend:

Detyra 3: Cili nga numrat e dhënë është numër i thjeshtë?

- A. 9
- B. 13
- C. 27
- D. 49

Vërejtje: Pyetjet më lartë u takojnë lëndëve dhe moshave të ndryshme të nxënësve.

Hapat e ndërtimit të një testi

Ndërtimi i një testi kërkon planifikimim dhe zbatimin e disa hapave të caktuar

Hapi i parë: Përcaktimi i temave ose njësive të cilat do të vlerësohen. Nëse testi do të përdoret si vlerësim përmbledhës për periudhën e parë të vitit shkollor (shtator- dhjetor), nxerrim temat që kemi zhvilluar me nxënësit gjatë kësaj periudhe. Nëse testi bëhet i përbashkët për një fushë të kurrikulës, nxerrim të gjitha temat e zhvilluara nga të gjitha lëndët e fushës përkatëse (p.sh. fizikë, kimi, biologji).

Hapi i dytë: Nxerrja e rezultateve të të nxënit për periudhën përkatëse nga kurrikula përkatëse lëndore. (Nëse testi bëhet për një kapitull atëherë nxjerrim rezultatet e të nxënit për atë kapitull ose temë). Pyetjet në test domosdoshmërisht duhet të lidhen me rezultatet e tënxënit.

P.sh. Nëse rezultati i të nxënit ka paraprë që nxënësi: •Klasifikon trekëndëshat sipas brinjëve dhe sipas këndeve, atëherë pyetja/detyra nëtest duhet të jetë:

Ndaj trekëndëshat në dy bashkësi: sipas brinjëve dhe sipas këndeve që kanë:

Hapi i tretë: Përcaktimi i llojeve të pyetjeve (të hapura, të mbyllura, me plotësim, etj)

Hapi i tretë: Përpilimi i tabelës së specifikimeve (bazuar në Taksonomië e Bloomit).

Hapi i pestë: Tëshkruarit e pyetjeve/ detyrave

Hapi i gjashtë: Pikëzimi dhe konvertimi në notë.

Tabela e përmbajtjes së testit – tabela e specifikimeve

Një test mund të përbëhet nga një pyetje e vetme apo një kombinim pyetjesh. Për të hartuar një test, mësimitdhënësi duhet të ketë kujdes që së pari të përgatisë tabelën e testit. Kjo tabelë përmban fushat e programit, përmbajtjet e të cilave do të testohen, si dhe numrin e pyetjeve dhe detyrave sipas niveleve të të nxënit dhe fushave. Përgatitja e tabelës së testit varet nga shumë faktorë, si p.sh. qëllimi i vlerësimit, volumi i përmbajtjes që testohet, rëndësia e fushave që përfshihen në vlerësim, përmbajtja e tyre, koha në dispozicion, etj.

Tabela e testit i orienton mësimitdhënësit në hartimin e tij. Caktimi i numrit të pyetjeve dhe detyrave sipas njësive mësimore dhe niveleve të të nxënit e lehtëson punën e mësuesit për hartimin e testit. Kjo pasi, në vend që mësuesi të shqyrtojë njëkohësisht 4 njësi mësimore për të hartuar pyetje dhe zgjedhur detyra të ndryshme, të cilat duhet klasifikuar sipas rëndësisë dhe nivelit të të nxënit, ai fokusohet në hartimin e pyetjeve dhe detyrave sipas tabelës. Pas përgatitjes së tabelës së testit, mësuesi kalon në hartimin e testit dhe kujdeset për tësi për anën përmbajtësore ashtu edhe për tregues të tjerë të pyetjeve, të themi të formës, Me këto tregues do të vijojmë në pjesët e mëposhtme të këtij materiali.

Tabela e specifikimeve ka dy përmasa; njëra përmasë (p.sh rresht) shënon temat/konceptet/etj. Në përmasën tjetër (p.sh kolona) shënohen nivelet njohëse qëdo të maten. Në rastin tonë është marrë një tabelë shembull për 5 tema të një kapitulli të ndarë sipas niveleve të njohjes.

Tabela 4. Tabelë testi me vlera numerike

FUSHA/LËNDA MËSIMORE		Të mbajturit mend	Të kuptuarit	Të zbatuarit	Të analizuarit, Të vlerësuarit Të krijuarit	SHUMA
		20 %	25 %	25 %	30%	
Tema 1	15%	1	1		1	3
Tema 2	15%		1	1	1	3
Tema 3	20%	1	1	1	1	4
Tema 4	25%	1	1	1	2	5
Tema 5	25 %	1	1	1	2	5
Shuma/pikëose pyetje		4	5	4	7	20

Një tabelë testi me vlera të dhënë në tabelën 4 paraqet dy aspekte të rëndësishme të vlerësimit:

- Çfarë të vlerësojë (prerjet e rreshtave me kolonat);
- Sa rëndësi/theks ka për çdo kombinacion të vlerësimit (vlerat e qelizave).

Në shembullin e mësipërm shohim që vlerësimi mbulon 5 tema, ku secila prej tyre shqyrtohet në tre katër nivelet e shkathtësisë së arsyetimit të menduarit: të mbajturit mend, të kuptuarit, të zbatuarit dhe mendimi kritik (të analizuarit, të vlerësuarit dhe të krijuarit). Vlerat e kutive/ qelizave janë vendosur nga prodhimi ndërmjet peshave të temave sipas shkathtësisë me totalin e pikëve të vlerësimit.

Procedura e krijimit të një table të tillë është si më poshtë:

- Identifikon temat që do të vlerësohen dhe vlerat relative të përqindjeve (duke plotësuar rreshtat),
- Përcakton nivelet e shkathtësitë njohëse dhe vlerat relative të përqindjeve (duke plotësuar kolonat),
- Përcakton totalin e pikëve (ose totalin e pyetjeve) të vlerësimit përmbledhës,
- Llogarit vlerat për çdo kuti (prerje të rreshtave me shtyllat) duke shumëzuar totalin e pikëve me peshat e kombinimeve,
- Bën rregullime të vlerave në kutia (p.sh. rrumbullakime, etj.) që të sigurohet që shuma e të gjitha vlerave të jetë e barabartë me totalin e pikëve të vlerësimit (ose totalin e pyetjeve të testit).

Përcaktimi i llojeve të pyetjeve

Pas përcaktimit në këtë mënyrë të zonës së vlerësimit (tabela e testit me vlerat), hapi tjetër është të vendoset për formatin e vlerësimit dhe llojin e pyetjeve që do të zgjidhen në përmbajtje të testit.

Testi për vlerësimin përmbledhës mund të përbëhet nga dy pjesë:

- 1 pjesa I - me alternativa ose përgjigje të strukturuar;
- 2 pjesa II –ese, problema apo krijim.

Pjesa I (me laps e letër) përmban pyetje me alternativa për vlerësimin e tëmbajturit mend dhe pyetje me përgjigje të strukturuar për vlerësimin e tëkuptuarit.

Pjesa II (vlerësimi) do të testojë aftësinë e nxënësve për të gjitha fushat duke përfunduar detyra / ushtrime-problema apo duke krijuar dicka të re (p.sh. shkruaj një paragraf duke përdorur fjalët kyçe: acar, transport, rrezik)

Rregulla bazë për të gjitha formatet e pyetjeve

Në hartimin e këtyre pyetjeve, përveç të tjerash, duhet të respektojmë disa rregulla bazë si mëposhtë:

- 1 sigurohuni të matni konceptet më të rëndësishme;
- 2 formuloni pyetje të qarta dhe koncize;
- 3 sigurohuni që pyetja i përgjigjet qëllimit të caktuar;
- 4 shmangni pyetjet e papërshtatshme në formë e përmbajtje;
- 5 shmangni pyetjet e vështira të pajustificuara;
- 6 shmangni pyetjet me kuptime të tjera logjike veç kuptimit që synojmë;
- 7 vendosni të parat pyetjet më të lehta;
- 8 nderlidhuni me kontekstin;
- 9 aplikoni pyetje bonus.

Numri i mjaftueshëm i pyetjeve në një test

Kjo është e varur tërësisht nga hapësira që vlerësojmë dhe qëllimet. Ka një rregull të përgjithshëm që dhjetë pyetje janë të nevojshme për të vlerësuar kompetencat e të mësuarit për një njësi/kapitull. Megjithatë në mjaft raste edhe vetëm 5 pyetje na sigurojnë një vlerësim të mirë.

Kur vlerësojmë nivelet e larta të njohjes dhe të tjera aftësi ne mund të përdorim vetëm disa pyetje dhe ndonjëherë vetëm një pyetje, pasi ato kërkojnë shumë kohë për përgjigje. Në rastet e vlerësimit përmbledhës për një periudhë mësimore, psh. VP2 për periudhën shtator-dhjetor, ku nxënësit do të marrin 40% të vlerësimit përmes testimit, rekomandohet që në test të vendosen pyetje nga të gjithë kapitujt e periud-

hës përkatëse. Numri i pyetjeve për një kapitull, varet nga RN të planifikuara për atë periudhë. Në varësi të ngarkesës së lëndës, mësimdhënësit mund të mbajnë dy teste përmbledhëse brenda një periudhe.

Llogaritja e kohës sëtestit

Sigurohuni të jepni një kohë të mjaftueshme nxënësve për përgjigjen e të gjitha pyetjeve. Mëtepër kohë është më mirë se më pak nga sa nevojitet. Mësuesi duhet të vlerësojë kohën qëi duhet atij për tu përgjigjur të gjitha pyetjeve. Zakonisht, nxënësve u duhet trefishi i kohës së një të rrituri për të zgjidhur një detyrë ose për të dhënë një përgjigje.

Mbi këtë kohë ai duhet të shtojë kohë për efekt të faktorëve të më poshtëm:

- Nxënësi është më i ngadaltë në procedurat e përgjigjeve dhe zgjidhjeve
- Nxënësi është nën presion
- Nxënësi bën gabime dhe i duhet t'i rikthehet zgjidhjes së saktë
- Nxënësi përgjithësisht ndjek rrugë më të gjatë zgjidhje dhe arsyetimi
- Nxënësi shpesh verifikon për here të dytë ose më tepër përgjigjet ose zgjidhjet.

Mësuesi duhet të ketëparasysh që të shmangë zgjatjet e panevojshme. Shumënga vlerësimet e shkurtra (pak pyetje) mund të na japin një pamje më të saktë të asaj çfarë nxënësi di në krahasim me një vlerësim të gjatë(shumëpyetje). E thënë më ndryshe duhet të shmangim zgjatjen e panevojshme të një testi. Zgjatja e panevojshme të shmang nga qëllimi kryesor, krijon konfuzion dhe presion për nxënësin.

Sigurohuni të konsideroni një sërë faktorësh të tjerësi socialë e psikologjikë të lidhura me kohën dhe vendin e testit, rëndësinë e tij, moshën, gjininë dhe përkatësinë kulturore-sociale të nxënësit.

Pikët, notat dhe nivelet

Në fund paraqitet edhe tabela e kthimit të pikëve në notë, pra notat në varësi të përqindjes së pikëve që kanëfituar nxënësit. Nuk ka rregull që përcakton lidhjen e notave me përqindjen e pikëve të fituara. Kjo më shumë varet nga synimi që ka mësimdhënësi në testimin e nxënësve dhe detyrat që ka përzgjedhur për test. Një tabelë e tillë ka pamjen e mëposhtme :

Tabela 5. Nga pikë- nënotë- nënival

Niveli(notimi)		
91% – 100%	5	A
81% – 90%	4	B
61% – 80%	3	C

41% – 60%	2	D
40%	1	

Pikët e caktuara për secilën detyrësi dhe tabela e kalimit të tyre në notë janë elementet themelore të cilat e bëjnë testin të jetë instrument për vlerësimin objektiv dhe transparent të nxënësve. Ky objektivitet dhe kjo transparencë vlen për nxënësit, prindërit, strukturat e ndryshme arsimore, si dhe palët e tjera të interesuara.

Testet që janë pjesë të teksteve mësimore

Mësuesit ankohen se ka raste kur provimet nuk janë në përputhje me programin për të cilin testi është planifikuar dhe ky është një problem që lidhet me vlefshmërinë e testit. Një pjesë shprehen që këto teste nuk janë gjithmonë të vlefshme.

Pra lypset të sigurohemi që testet dhe provimet të përmbushin standardet e vlefshmërisë dhe në këtë mënyrë të matin sa më saktë atë që është e planifikuar. Kështu ato shërbejnë si modele që nxënësi të vlerësojë veten në fund të një njësie kapitulli, mësuesi gjithashtu t'i shqyrtojë modele për hartimin e testit të njësisë/kapitullit apo si modele për skicimin e testeve të tjerë.

LLOJET KRYESORE TË PYETJEVE DHE RREGULLAT E TË SHKRUARIT TË TYRE

Llojet kryesore të pyetjeve

Gjatë përpilimit të testeve për nxënësit e klasave 1 deri 12-të, rekomandohet që të përdoren lloje të ndryshme të pyetjeve. Zakonisht pyetjet në fillim të testit rekomandohet të jenë më të lehta për nga vështirësia dhe të pasohet me pyetje më të vështira. Pyetjet përpilohen duke u bazuar në rezultatet e të nxënësve për lëndën përkatëse. Mësimdhënësit nuk mund të vendosin në test pyetje të cilat nuk kanë qenë pjesë e kurrikulës lëndore apo nuk përkon me qëllimin, parimet dhe kompetencat e arsimit parauniversitar.

Përveq kujdesit në përmbajtje, element i rëndësishëm është edhe ofrimi i pyetjeve të llojeve të ndryshme me qëllim të motivimit të nxënësve sipas stilit të të nxënësve që kanë. Rekomandohet që disa pyetje/ kërkesa apo detyra të shoqërohen me vizatime e figura konkrete pse jo edhe vet pyetja të jetë e fokusuar në analizën e një fotografie, grafiku me të dhëna apo figure. Më poshtë janë paraqitur disa lloje të pyetjeve që mund të jenë pjesë e testeve. Rekomandohet që pas perfundimit të cdo kapitulli, mësimdhënësi të shkruaj në një document 3 deri 4 pyetje të cilat pastaj do të përbëjnë bankën e pyetjeve për tërë lëndën dhe ju vetëm do të përzgjedhni prej tyre një numër të caktuar, në fund të periudhës përkatëse.

Pyetjet me plotësim ose me përgjigje të shkurtëra

Këto janë pyetje në formën e një fjalie që i mungon një pjesë, e cila mund të jetë fjalë a togfjalësh. Mund të jetë edhe një pjesë teksti, me pjesë të paplotësuara. Vendosja e pjesëve të munguara i jep kuptimin e duhur fjalisë apo tekstit kuptimin e plotë. Këto pyetje zakonisht testojnë nohuri bazike, ose fakte kyce ose nocione.

Udhëzime të të shkruarit të pyetjeve me plotësim

Ndërtoni fjalinë në mënyrë që përgjigja e vërtetë të jetë e shkurtër dhe vetëm një. Shembull:

I dobët: Kolumbi shkeli për herë të parë “Amerikë” _____.

I përmirësuar: Kolumbi shkeli për herë të parë në “Amerikë” në vitin _____.

Pjesën që mungon është më mirë ta vendosim në fund të fjalisë se në fillim të saj. Shembull:

I dobët: _____ është elementi bazë i fotosintezës te bimët.

I përmirësuar: Elementi bazë i fotosintezës te bimët është _____.

Lejoni vetëm një ose dy hapësira boshe në fjali.

Shembull:

I dobët: Sistemi kryesor në qeniet njerëzore i nevojshëm për _____ me anë të trupit është _____.

I përmirësuar: Sistemi kryesor në qeniet njerëzore i nevojshëm për lëvizjen e lëndëve ushqyese në të gjithë trupin është _____.

Pyetjet me alternativa

Këto pyetje japin një trung në formën e një pyetjeje apo fjalie të paplotë dhe disa alternativa (tre, katër ose më shumë...) një prej të cilave është e vërtetë (ose përgjigja më e vërtetë dhe pjesa tjetër janë alternativa jo të vërteta. Ato zaonisht përdoren për vlerësimin e njohurive, për krahasime, zbatime të thjeshta, njohje e zbatim ligjesh e rregullash të thjeshta, formula e koncepte, për vlerësim të një materiali stimulus, etj.

Krijimi i pyetjeve me alternativa merr shumë kohë por kontrollimi i testeve të tilla është shumë i shpejtë sepse nxënësit rrethojnë vetëm përgjigjen e saktë e cila i ka pikët e caktuara. Përmes një celësi të testit, kontrollimin e tyre mund ta bëjë cdo kush.

Udhëzime të shkruarit të pyetjeve me alternativa

Sigurohuni që trangu i pyetjes shpreh në mënyrë të plotë një çështje në mënyrë që nxënësit të dinë mirë të bëjnë atë çfarë shpresohet prej tyre para se të lexojnë alternativat. Mos përdorni fjali të marrura drejtpërdrejtë nga teksti por shkruani ato me fjalët tuaja.

Ikni	Përdorni
<p>Në trung:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fjalive të gjata të komplikuar • Deklaratave të parëndësishme që nuk lidhen shumë me pyetjen përkatëse • Fjalive negative (kush nuk e ...) • Pyetjet: Cila nga deklaratat më poshtë është e saktë? <p>Në alternativa:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Deklaratat që janë shumë afër përgjigjes së saktë • Përgjigje plotësisht të papranueshme që nënkuptohen si të pasakta menjëherë • Deklaratat: 'Të gjitha sa më sipër,' 'asnjë nga sa më sipër' • Përgjigjet e mbivendosura (p.sh. sa kromozome përmbanë një qelizë tipike njerëzore: A: 12; B: 18; C: 32; D: 24. Pra kjo është e mbivendosur sepse qeliza që përmbanë 18 kromozome përmbanë edhe 12, ajo që përmbanë 32 përmbanë edhe 18 edhe 12 dhe 24. • Përgjigje pjesërisht të sakta; 	<p>Në trung:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fjali tuajat dhe jo të marrura drejtpërdrejtë nga teksti • Një pyetje/problem të qartë dhe konciz. • Pyetje të ndërlidhura me kontekstin (psh nëse nxënësit jetojnë në Prishtinë, mund të shtrohen pyetje që lidhen me parkun e Germisë, sheshin Nëna Terezë, lagje të caktuara etj. Shembull: Jeni duke vrapsur në parkun e Germisë dhe keni vërejtur se drunjëve i'u janë formuar në njërin anë të trupit disa shtresa bimësh të gjelbërta. Si quhen ato dhe përse janë vetëm në njërin anë të trupit të drurit? <p>Në alternativa:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpërqendruar bindës dhe homogjenë. • Deklarata të bazuara në keqkuptime të zakonshme të studentëve • Deklarata të vërteta që nuk u përgjigjen pyetjeve • Opsione të shkurtra - dhe të gjitha në gjatësi afërsisht të njëjtë • Të paktën 3, 4 alternativa • Përdorni shkronja të mëdha shtypi për të shënuar alternativat. Kështu është më lehtë për nxënësit me probleme të të lexuarit.

Përparësi të pyetjeve me alternativa:

- Mund ta përdorim për të testuar shumë nivele të të mësuarit
- Mund të përdoret për të testuar aftësinë e nxënësit për të integruar informacionin
- Mund të përdoret për të diagnostikuar vështirësinë e nxënësit për koncepte të caktuara
- Na siguron informata kthyesë për alternativat e gabuara dhe të saktën për mënyrën si ato kanë funksionuar
- Mund të shtojmë më shumë pyetje për të mbuluar më shumë program
- Mund të mbulojmë më shumë nivele vështirësie
- Zakonisht duan më pak kohë për përgjigje nga nxënësit

Mangësi të pyetjeve me alternativa:

- Mund të perceptohet më e ndërlikuar
- Nuk janë të përshtatshme për të matur qëndrimet ndaj të mësuarit pasi përgjigja e vërtetë mund të gjendet lehtë edhe indirekt edhe rastësisht
- Nuk lejon të demonstrohen njohuri jashtë opsioneve të dhëna
- Kërkon kohë për të arritur në pyetje të cilësisë së lartë të këtij lloji
- Favorizon parashikimin (marrjen mend) pasi gjithmonë një është përgjigje e vërtetë
- Janë të mundshme për keqinterpretim nga nxënësit

Pyetjet E vërtetë/E gabuar

Pyetjet E vërtetë/E gabuar përdoren në mënyrë tipike për të matur aftësinë e të dalluarit nëse një pohim është ose jo i vërtetë. Pyetjet janë zakonisht në një formë deklarative që nxënësi duhet të shprehë nëse janë të vërteta apo të gabuara. Këto kërkesa nuk jepen si të vetmuara por 4-5 deklaratat apo detyra për ta zvogëluar mundësinë e hamendësimit.

Udhëzime të të shkruarit të pyetjeve “E vërtetë/E gabuar”

Shkruajeni pyetjen që opsionet e përgjigjes të jenë në përputhje me logjikën e fjalisë.

Për shembull nëse doni të testoni “shqiptimin”, nuk ka kuptim të përdorni formatin “e vërtetë/e gabuar” si opsion të përgjigjes, e saktë/e pasaktë do të ishte një formë më e përshtatshme të shkruari.

Përdorni “e vërtetë/e gabuar” vetëm për të vlerësuar informacionin që është fakt dhe jo objekt i debatit apo gjykimit.

Shembuj:

I dobët: Një paralelogram mund të jetë drejtkëndësh.

- E vërtetë
- E gabuar

I përmirësuar: Paralelogrami që ka një kënd të drejtë, është drejtkëndësh.

- E vërtetë
- E gabuar

Shkruani fjali që janë plotësisht të vërteta ose plotësisht të gabuara. MOS bashkoni informacion të vërtetë me të gabuar në një pyetje të vetme.

I dobët: Shprehja shkronjore 3a prodhon shumëfishat e numrit 3 ose të numrave të tjerë.

- E vërtetë
- E gabuar

I përmirësuar: Shprehja shkronjore 3a prodhon shumëfishat e numrit 3.

- E vërtetë
- E gabuar

Pohimet e gabuara duhet të jenë gabime të zakonshme. Mos u mjaftoni vetëm duke vendosur NUK!JO në një pohim për ta bërë atë të gabuar.

Shembull:

I RREGULLT:

Për cilën vlerë të n-së vërtetohet

barazimi $x^n = (-x)^n$

- 3
- 4
- 5
- 7

I GABUAR

Për cilën vlerë të n-së NUK vërtetohet

barazimi $x^n = (-x)^n$

- 3
- 4
- 5
- 7

- Shmangni fjalitë e gjata.

Shembull:

I dobët: Një filxhan me ujë të nxehtë me një lugë brenda tij do të ftohet më shpejt nga një filxhan me të njëjtën sasi uji të nxehtë, por që nuk ka lugë si në rastin e parë.

- E vërtetë
- E gabuar

I përmirësuar: Uji i nxehtë në një gotë ftohet më shpejt, nëse vendosim një lugë në të.

- E vërtetë
- E gabuar

- Shmangni falë të tilla si; asnjëherë, gjithë, çdo dhe absolutisht, që janë tipike që të këshillojnë alternativën e gabuar.

- Shmangni përdorimin e mbiemrave dhe ndajfoljeve të paqarta të tilla si; shpesh, ndonjëherë, rastësisht për të vetmin fakt që ato përdoren në mënyra të ndryshme nga studentë të ndryshëm.

Pyetjet me shoqërim

Pyetjet me shoqërim (kush/kujt i përket) ndërtohen duke dhënë një listë fjalësh stimuluese (mjedise/ premisa) dhe një bashkësi tjetër me përgjigjet fjalë/shprehje apo piktura.

Këto pyetje përdoren shpesh për të vlerësuar njohjen dhe të kujtuarit dhe kështu përdoren më shpesh në kurse ku përvetësimi i njohurive të hollësishme është një qëllim i rëndësishëm. Ato zakonisht janë të shpejta dhe të lehta për t'u krijuar dhe shënuar, por nxënësit kërkojnë më shumë kohë për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve sesa tek pyetjet me alternativa ose “ e vertete, e gabuar”.

TABELA 12. Forma

PREMISA	PËRGJIGJE
Premisa 1	Përgjigje a
Premisa 2	Përgjigje b
Premisa 3	Përgjigje c
Premisa 4	Përgjigje d
	Përgjigje e

Shembull 1.

Për tabelën 12 më poshtë gjeni kush nga kolona I i përket kujt nga kolona II dhe lidhini me shigjetë

I DOBËT:

- | | |
|-------------------------------------|--------------------|
| Ujë | • NaCl |
| Ka zbuluar Radiumin | • Curie |
| Viti i nisjes së luftës II botërore | • NH ₃ |
| Amonjak | • H ₂ O |
| Kripë | • 1939 |

I PËRMIRËSUAR:


Për çdo përbërës në të majtë në kolonën I gjeni kush formulë i përket nga kolona II dhe lidhini me shigjetë. Çdo formulë përdoreni vetëm një herë.

- | | |
|---------------|----------------------------------|
| Ujë | • H ₂ SO ₄ |
| Kripë | • NH ₃ |
| Amonjak | • NaCl |
| Acid sulfurik | • H ₂ O |

Pyetje me prezantim viziv/grafik

Shembull:

Gjatë lëvizjes së ndryshueshme të trupave, ata e ndryshojnë shpejtësinë. Vizatoni pjesët e grafikut në sektorët e shënuar me A,B,C,D, grafikun e lëvizjes sipas kërkesave.



- (A) PJESA A E GRAFIKUT - TRUPI LËVIZ DUKE E RRITE SHPEJTËSINË
 (B) PJESA B E GRAFIKUT - TRUPI LËVIZ DUKE E MBAJTE TË NJËJTËN SHPEJTËSINË
 (C) PJESA C E GRAFIKUT - TRUPI LËVIZ DUKE E ZVOGËLUAR SHPEJTËSINË
 (D) PJESA D E GRAFIKUT - TRUPI NUK ËSHTË DUKE LËVIZUR

Pyetjet në formë të problemave. Rëndësia dhe metoda të zgjidhjes së tyre

Teoria dhe praktika sugjeron që në zgjidhjen e problemave të menduarit është më i rëndësishëm se njohuritë .

Zgjidhja e problemës është një prej kategorive më të larta të të menduarit që mësuesit përdorin me nxënësit t'u mësojnë si të mendojnë, kur vetëm njohuritë nuk mjaftojnë për zgjidhjen e problemës. Për të pasur sukses në këto lloj pyetjesh, nxënësit duhet të ballafaqohen me to vazhdimisht gjatë mësimdhënies dhe të nxënit. Nëse planifikojmë rezultate të nxënit me nivel të ulët të të menduarit dhe zbatojmë metodologji me mësuesin në qendër nuk pritët që nxënësit të jenë të suksesshëm në zgjidhjen e tyre në test.

Çfarë është zgjidhja e një probleme

Në zgjidhjen e një probleme nxënësi përmbledh gjithë sa ka mësuar më parë dhe i zbaton ato në situatën e problemës, që është e re dhe e ndryshme nga çfarë ai ka mësuar më parë.

- *Zgjidhja e një probleme nuk është thjesht një algoritëm.*

Ekzistenca e një problemi nënkupton se nxënësi është përballur me diçka që nuk e njeh, për të cilën nuk mund të zbatohet thjesht një model. Një problem nuk mund të konsiderohet më i tillë, kur mund të zgjidhet lehtë nga algoritme të mësuara më parë. (Krulik and Rudnick -1980).

- Zgjidhja e një probleme lidh teorinë me praktikën.

Në mënyrë specifike zgjidhja e një probleme mundëson zbatimin e njohurive abstrakte të shkollës në përvoja konkrete të botës reale.

- Zgjidhja e një probleme na mëson të jemi krijues.

Probleme të ndryshme të jetës reale kërkojnë krijimtari. Zgjidhja e problemave zhvillon të nxënësit kapacitete krijuese.

- Zgjidhja e problemës si një varg instruksionesh.

Është procesi i ndjekjes së një radhe (vargu) instruksionesh (udhëzimesh), që nxënësi përdor në situata të ndryshme jetësore.

Shembull: Në një darkë janë ftuar 12 çifte. Tryeza e darkës është e formuar nga Bashkimi i disa tryezave të vogla katrore që formojnë një tryezë të madhe të gjatë. Gjeni sa tavolina të vogla katrore duhen për të ulur këta 24 të ftuar.

Hapi I – të lexuarit e problemit

Nxënësi identifikon disa nga konceptet e dhëna, p.sh. tavolina të vogla katrore, 12 çifte, bashkimi i disa tryezave të vogla katrore, tryezë e madhe e gjatë, 24 të ftuar.

Hapi II – kërkimi

Nxënësi kërkon të gjejë kush janë konceptet kryesore dhe si janë të lidhura me përmbajtjen e problemës. Në një farë mënyre ai kërkon si ta kuptojë më thjesht problemën. Në këtë fazë ai mund të vizatojë edhe një skicë/ tabelë ku vendos në radhe një tryezë, dy tryeza, tre,.. e kështu vazhdon.

Hapi III – zgjedhja e një strategjie


Nxënësi nxjerr përfundime ose ngre hipoteza pas dy hapave më sipër. Në këtë fazë ai hamendëson ose supozon një zgjidhje.

Hapi IV – zgjidhja e problemës

Pasi e ka zgjedhur metodën, nxënësi e zbaton atë në rastin e problemës. Në shembullin tonë ai do të vazhdojë sipas hapit III me skicën apo grafikun derisa të ulë 24 të ftuarit.

Shembull: Hapi II - Kërkimi.

Vizaton një skicë/diagram me të dhënat e problemës.



Bën një tabelë, shënon të dhënat dhe kërkon ose zbulon lidhjet e tyre.

NUMRI I TRYEZAVE	1	2	3	4	-	-	-
NUMRI I TË FTUARVE	4	6	8	10	-	-	-

Rasti ynë: kur shtojmë një tryezë, numri i të ftuarve që ulen rritet me 2.

Shembull: Hapi III - Zgjedhja e një strategjie.

NUMRI I TRYEZAVE	1	2	3	4	5	6	7
NUMRI I TË FTUARVE	4	6	8	10	12	14	16

Nxënësi tenton të ngrejë një hipotezë meqë modeli i krijuar është i vërtetë ose funksionon për 16 të ftuar. Ne mund të vazhdojmë të shtojmë nga një tavolinë për çdo çift të ftuarish që kanë mbetur ($16 + 8 = 24$). Hipoteza; do të duhen 11 tryeza për të ulur 24 të ftuarit.

Shembull: Hapi IV - Zgjidhja e problemit.

NUMRI I TAVOLINAVE	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
NUMRI I TË FTUARVE	4	6	8	10	12	14	16	18	20	22	24

Hapi final, prova dhe përgjithësimi

Nxënësi vërteton përgjigjen e tij dhe kërkon për variacione të zgjidhjes së problemës. P.sh gjen një formulë $t = (n - 2)/2$, ku kemi shënuar t – numrin e tryezave dhe n – numrin e të ftuarve. Një tjetër, p.sh. mund të kërkojë dhe gjejë një formulë që lidh numrin e të ftuarve në varësi të tryezave, $n = 2t + 2$ ose $n = 2(t + 1)$.

Pyetjet ese ose pyetjet me fund të hapur

Pyetjet ese kërkojnë përgjigje e cila është e strukturuar në formë të eseut. Përgjigjja mund të jetë e gjatë disa paragrafë deri tek disa faqe, varësisht prej moshës së nxënësvë. Ky lloj i pyetjeve përdoret për të matur nivel më të lartë të të menduarit dhe në të shumtën e rasteve kërkojnë analizë, vlerësim dhe krijim, prandaj dhe japin më shumë pikë për nxënësit. Ky lloj i pyetjeve kërkon kohë më të gjatë për përgjigje prandaj mësimeve zakonisht rekomandojnë vetëm një pyetje ese në tërë testin.

Tema e përcaktuar për ese ose pyetja, nuk duhet të jetë shumë e gjerë por ajo duhet të jetë shumë specifike. Duhet të dihen qartë kriteret e vlerësimit dhe pikët për secilin kriter. P.sh. përmbajtja, struktura, drejtshkrimi, secila ka pikët e përcaktuara.

Përparësi të pyetjeve me fund të hapur

Për disa rezultate të të nxënësve, testet që përmbajnë pyetje me fund të hapur janë më të vlefshme se testet që përmbajnë vetëm pyetje të mbyllura; kjo është veçanërisht e vërtetë kur nxënësit vlerësohen për shprehje komplekse.

Pyetjet me fund të hapur u japin nxënësve më shumë liri në formulimin e përgjigjeve të tyre duke u dhënë mundësi për më shumë kreativitet.

Mangësi të pyetjeve me fund të hapur

Janë të vështira për tu formuluar sidomos në sensin që nxënësi ta kuptojë qartësisht çfarë lloj përgjigjeje duhet të japë. Vështirë është të përcaktohen kriteret e suksesit dhe shpesh ka subjektivitet në vlerësim.

Vlerësimi me pikë është i ndryshëm nga njëri vlerësues te tjetri. Në fakt ne synojmë që sistemi i vlerësimit me pikë të jetë sa më i qëndrueshëm. Vlerësimi me pikë i përgjigjeve merr më shumë kohë.

Përveç rregullave të mësipërme, për të gjitha format e pyetjeve, ka edhe rregulla të tjera që mësuesit e specialistët i njohin. Ne kemi synuar të paraqesim disa prej tyre dhe mundësisht ato më kryesoret. Zbatimi i rregullave të të shkruarit të pyetjeve është një garanci shumë e mirë për të prodhuar pyetje cilësore.

Hartimi i pyetjeve sipas standardeve më të mira të përshkruara dhe kombinimi i tyre sipas rubrikave të përshkuara në pjesët e tjera të materialit na garanton ndërtimin e një testi përmbledhës me standarde të larta.

ANALIZË TESTI/PYETJESH

Analiza e pyetjeve

Pas përfundimit të një testi, rekomandohet që mësime dhënësit të analizojnë të dhënat nga rezultatet e testit jo për qëllime të gjyqimit të arritjeve të nxënësve por edhe për të verifikuar cilësinë e testit dhe për vet reflektim. Analiza e pyetjeve ngërthen nëvete vlerësimin sasior të pyetjeve sipas shkallës (pikët e fituara). Qëllimi është për të marrë më shumë informacion mbi çdo pyetje, për të përcaktuar mbajtjen, fshirjen, apo rishikimin e tyre. Dy tregues të rëndësishëm për analizimin e pyetjeve janë:

- A. Vështirësia e pyetjes
- B. Diskriminimi i pyetjes

Vlerësimet tjera që përdoren për analizë të pyetjeve janë:

- A. Të hamendësuarit** - nëse studentët lehtë mund të kenë përjashtuar një ose më shumë alternativa, atëherë shansi i të hamendësuarit është rritur, duke zvogëluar vlerën e diskriminimit të asaj pyetje.
- B. Pyetjet paragjyquese** - pyetjet për të cilat personat me zotësi të barabartë, nga grupe të ndryshme kulturore kanë probabilitete të ndryshme të suksesit. Dallimet në vështirësinë e pyetjes, vlerën e diskriminimit, etj., çojnë në modele të ndryshme për të reflektuar. Diferencimi mund të tregojë se pyetjet e testimit nuk janë duke matur të njëjtin formim për secilin grup.
- C. Pyetjet jashtë programit** - këto lloj pyetjesh mund të konstatohen kur nuk kanë marrë përgjigje nga nxënësit e avancuar. Në këtë rast pyetja duhet analizuar nëse ka qenë lehtë ose jashtë programit. Kur pyetja është e lehtë nxënësi i avancuar shfaq më shumë hezitim për t'u përgjigjur duke menduar se pyetja mund të ketë probleme. Rasti i mbetur, kur pyetja është brenda intervalit të vështirësisë, është që ajo të jetë jashtë programit ose në zonë të parëndësishme të tij. Shmangia e këtyre lloj pyetjesh mundësohet nga bërja sa më mirë e tabelës së përmbajtjes së testit.

Pyetjet paragjyquese – udhëzime⁵

- Rishikoni ose hiqni vlerësime apo pyetje, që nxisin stereotipat.
- Rishikoni ose hiqni vlerësime që mund të ndikojnë në mënyrë të padrejtë në performancën e individëve ose grupeve të nxënësve.
- Shmangni gjuhën që është tepër konfuzë ose komplekse dhe çon në vlerësime të padobishme.
- Shmangni temat e vlerësimit që mund të shqetësojnë ose të jenë shumë të ndjeshme për nxënësit, nëse nuk ka një kërkesë detyruese për të vlerësuar këto tema.
- Minimizoni të gjithë faktorët e parëndësishëm që mund të ndikojnë në gjykimin dhe rezultatin e performancës së nxënësve si:
 - Faktorët stilistik të tillë si shkrimi i dorës, fjalori i përdorur ose struktura e fjalive, kur qëllimi i një vlerësimi të shkruar është të vlerësojë vetëm përmbajtjen dhe të menduarit;
 - Paragjykimi i mësuesit që mund të rezultojë në një tendencë të përgjithshme për të qenë shumë bujar ose shumë i ashpër; dhe
 - Efekti, ku njëpërshypje e përgjithshme ose vlerësim i mëparshëm ndikon vlerësimin e tanishëm.

Rishikim Testi

- Vlerësimi i anëve të forta dhe të dobëta të pyetjeve
- Ndryshimet në bazë të analizave të rezultateve
- Rishikoni qëllimet e testit për të zbatuar çdo ndryshim

Analiza e shpeshtësisë

Analiza e shpeshtësisë mat numrin e herëve që zgjidhet secila alternativë nga nxënësit. Nëse alternativa të caktuara zgjidhen pak, ato mund të jenë të paefektshme dhe duhet të mendoni t'i zëvendësoni me alternativa më konkurruese. Kjo lloj analize mund të bëhet nëse vlerësimi bëhet në mënyrë elektronike me programe të cilat mundësojnë analiza statistikore.

Vështirësia e pyetjes

Vështirësia e një pyetjeje matet duke pjesëtuar numrin e përgjigjeve të sakta me numrin total të përgjigjeve. Vështirësia shkon nga 0 në 1 (0 shumë e vështirë, me asnjë nxënës që të jetë përgjigjur saktë dhe 1 që nënkupton që të gjithë pjesëmarrësit në test janë përgjigjur saktë).

$$V = R/N$$

V = Vështirësi

R = numri i nxënësve që kanë dhënë përgjigje të sakta të pyetjes N = numri i përgjithshëm i nxënësve

Rekomandime për variacionet e vlerave V. Rekomandime për vlerat e pranueshme të V. Disa shembuj të vlerave të pranueshme për V të hasura në literature janë: 0.2 në 0.9, 0.4 në 0.85 dhe 0.3 në 0.7.

Ne rekomandojmë intervalin 0.25 në 0.75 që përdoret edhe në Shqipëri. Pyetja me vlerë V në intervalin 0-0.25 do të thotë se është më e vështirë se duhet. Pyetja me vlerë V në intervalin 0.75-1.00 do të thotë se është më e lehtë se duhet.

Shembull. Le të konsiderojmë se jepen dy pyetje me alternativa, ku për secilën duhet të zgjedhësh përgjigjen e saktë ndërmjet katër mundësive (A, B, C, dhe D). Në tabelën 9 tregohet sa student zgjedhin përkatësisht secilën prej alternativave (për Pyetjen #1 dhe #2).

Vështirësia e pyetjes

PYETJA	A	B	C	D
#1	0	3	24*	3
#2	12*	13	3	2

* tregon përgjigjen e saktë.

Për Pyetjen #1, ne vërejmë që A nuk është një alternativë e mirë—asnjeri nga nxënësit nuk e ka zgjedhur si përgjigje. Ne gjithashtu mund të njehsojmë vështirësinë e pyetjes duke pjesëtuar numrin e nxënësve që kanë zgjedhur përgjigjen e saktë (24) me numrin total të nxënësve (30).

Duke përdorur këtë formulë, vështirësia e Pyetjes #1 është $24/30$ ose 0.8.

Një rregull i përgjithshëm është që nëse vlera për vështirësinë e pyetjes është më e madhe se 0.75, ajo është një pyetje e lehtë. Nëse vlera e vështirësisë është më e vogël se 0.25, ajo është një pyetje e vështirë.

Duke pasur parasysh këto parametra, kjo pyetje do të mund të konsiderohet mesatarisht e lehtë- shumica (80%) e nxënësve janë përgjigjur korrekt.

Pyetja #2 është shumë më vështirë ($12/30 = 0.40$). Në të vërtetë, në Pyetjen #2, më shumë nxënës zgjedhin përgjigjen (B) krahasuar me ata që zgjedhin përgjigjen (A). Kjo pyetje duhet analizuar me kujdes për të siguruar që B është një alternativë e duhur (e përshtatshme).

Diskriminimi i pyetjes

Njëzet matje, *Koeficienti i Diskriminimit*, ka të bëjë me sa diferencon një vlerësim ndërmjet pikëve të larta dhe të ulëta. Me fjalë të tjera, ju duhet të bëni të mundur që nxënësit me arritje të larta duhet të kenë zgjedhur alternativën e saktë në një pyetje më shumë herë sa e kanë zgjedhur atë të grupi i nxënësve me arritje më të ulëta.

Nëse arrijmë këtë themi se kemi një diskriminim pozitiv (ndërmjet 0 dhe 1). Kjo do të thotë se nxënësit që kanë marrë më shumë pikë në përfundim të testit zgjedhin alternativën e saktë për një pyetje të caktuar më shumë herë se e zgjedhin atë nga grupi i nxënësve me pikë të përgjithshme të ulëta. Nëse ju gjeni që grupi i nxënësve me pikë të përgjithshme të ulëta janë përgjigjur saktë më shumë herë, atë herë pyetja ka koeficient negativ të diskriminimit (ndërmjet -1 dhe 0).

Ndiqui hapat e mëposhtëm për të përcaktuar Koeficientin e Vështirësisë dhe Koeficientin e Diskriminimit.

1. Pasi t'i keni renditur nxënësit duke vendosur më lart atë që ka fituar më shumë pikë, numëroni sa nga ata janë në grupin e pikëve më të larta dhe sa nga grupi i pikëve të ulëta që i janë përgjigjur saktë pyetjes. Për pyetjen #1, janë 4 nxënës në gjysmën e sipërme, që janë përgjigjur saktë për pyetjen dhe 4 nxënës në gjysmën e poshtme.
2. Përcaktoni Koeficientin e Vështirësisë duke pjesëtuar numrin e nxënësve që janë përgjigjur saktë me totalin e numrit të nxënësve. Për Pyetjen #1 ky do të jetë $8/10$ ose $V(p)=0.80$.
3. Përcaktoni koeficientin e diskriminimit duke zbritur nga numri i nxënësve që i janë përgjigjur pyetjes saktë në grupin e pikëve të larta, numrin e nxënësve që janë përgjigjur saktë pyetjes në grupin e pikëve të ulët. Pastaj, rezultatin e pjesëtoni me numrin e nxënësve të çdo grupi (që në rastin tonë janë 5 në çdo grup).

Për pyetjen #1, kjo do të thotë që duhet të zbritni 4 nga 4, ta pjesëtoni me 5 dhe rezultati për Koef. e Diskriminimit del 0.

Përgjigjet për Pyetjet 1 – 3

$$D = (H-L)/N$$

D = diskriminimi. H = numri i përgjigjeve të sakta nga gjysma e sipërme (gjysma qëka fituar më shumë pikë) e pikëve tëtestit. L = numri i përgjigjeve të sakta nga gjysma e nxënësve qëka fituar mëpak pikë në test.

N = numri i nxënësve të një nëngrupi.

Shembull. Në tabelën 9 tregohen rezultatet e 10 pyetjeve nxënësve të një testi. Vini re që nxënësit janë renditur duke vendosur në krye atë që ka fituar më shumë pikë.

Diskriminimi i pyetjes

NXËNËS	TOTAL PIKË (%)	PYETJET		
		1	2	3
Nxënës 1	93	1	0	1
Nxënës 2	90	1	0	1
Nxënës 3	82	0	0	1
Nxënës 4	80	1	0	1
Nxënës 5	70	1	0	1
Nxënës 6	60	1	0	0
Nxënës 7	60	1	0	1
Nxënës 8	50	1	1	0
Nxënës 9	44	1	1	0
Nxënës 10	40	0	1	0

"1" tregon qëpërgjigja është e saktë; „0" tregon përgjigje tëpasaktë.

Ndiqui hapat e mëposhtëm për të përcaktuar Koeficientin e Vështirësisë dhe Koeficientin e Diskriminimit.

- Pasi t'i keni renditur nxënësit duke vendosur më lart atë që ka fituar më shumë pikë, numëroni sa nga ata janë në grupin e pikëve të larta dhe sa nga grupi i pikëve të ulëta qëi janë përgjigjur saktë pyetjes. Për pyetjen #1, janë 4 nxënës në gjysmën e sipërme, që janë përgjigjur saktë për pyetjen dhe 4 nxënës në gjysmën e poshtme.
- Përcaktoni Koeficientin e Vështirësisë duke pjesëtuar numrin e nxënësve që janë përgjigjur saktë me totalin e numrit të nxënësve. Për Pyetjen #1 ky do të jetë $8/10$ ose $V(p)=0.80$.
- Përcaktoni koeficientin e diskriminimit duke zbritur nga numri i nxënësve qëi janë përgjigjur pyetjes saktë në grupin e pikëve të larta, numrin e nxënësve që janë përgjigjur saktë pyetjes në grupin e pikëve të ulët. Pastaj, rezultatin e pjesëtoni me numrin e nxënësve të çdo grupi (qënë rastin tonë janë 5 në çdo grup).

Për pyetjen #1, kjo do të thotë që duhet të zbritni 4 nga 4, ta pjesëtoni me 5 dhe rezultati për Koef. e Diskriminimit del 0.

Përgjigjet për Pyetjet 1 – 3

PYETJA	# SAKTË(GRUPI I SIPËRM)	# SAKTË(GRUPI I ULËT)	VËSHITËRËSIA V(P)	DISKRIMINIMI (D)
Pyetja 1	4	4	0.80	0
Pyetja 2	0	3	0.30	- 0.6
Pyetja 3	5	1	0.60	0.8

Tani që kemi tabelën e plotësuar, çfarë nënkupton? Në vërejmëse Pyetja # 2 ka një koeficient vështirësie 0,30 (do të thotë shumë vështirë) dhe për më tepër ka koeficientin e diskriminimit negativ -0,6 (do të thotë se nxënësit me arritje më të ulëta kanë qenë më të prirur për të dhënë përgjigje të saktë). Kjo pyetje duhet analizuar me kujdes, dhe ndoshta duhet ndryshuar ose hequr. Pyetja më mirë nga të gjitha paraqitet Pyetja 3, e cila ka një nivel të kënaqshëm vështirësie (0.60) dhe diskriminon jashtëzakonisht mirë (0.80).

Sa nga pyetjet kanë vështirësi mesatare? Këto janë më të mirat, sepse ato sigurojnë mundësinë e më të mirë për të diskriminuar (për ta vërejtur këtë, shihni koeficientet e diskriminimit maksimal të tyre në radhën e parë të titujve). Pyetjet të cilave shumica e nxënësve u përgjigjet mirë, ose shumica u përgjigjet gabim thjesht nuk mund të diskriminonin shumë.

Prova më e rëndësishme për diskriminimin e një pyetje është krahasojmë atë me maksimumin e mundshëm. Sa mirë diskriminon secila pyetje lidhur me maksimumin e mundshëm?

Mëposhtë jepet një rregull i përafërt:

- Diskriminimi është pranë maksimumit të mundshëm = pyetje shumë diskriminuese;
- Koeficienti i Diskriminimit është afërsisht sa gjysma e maksimumit të mundshëm = pyetje me diskriminim të kënaqshëm.
- Koeficienti i Diskriminimit është afërsisht sa çereku i maksimumit të mundshëm = pyetje e dobët
- Koeficienti i Diskriminimit është afër zero = pyetje që nuk diskriminon
- Koeficienti i Diskriminimit është negativ = pyetje e keqe (hiqeni nëse është më e vogël se -0.1)

DOKUMENTIMI DHE RAPORTIMI I VLERËSIMIT TEK NXËNËSIT, PRINDËRIT DHE AKTERËT E TJERË

Vlerësimi i nxënësve, i brendshëm dhe i jashtëm, nuk paraqet një raport të mbyllur midis mësimit dhe nxënësit por ka ndërlidhje edhe me akterët e tjerë prindërit, këshillat e mësimit, drejtorët, DKA, MASHT etj. Kjo tregon se mësimit japin llogari për arritjet e rezultateve të nxënësve para gjithë komunitetit. Kjo qndron edhe dobishmëria e vlerësimit si një nga parametret e përgjithshme të tij.

Fillimisht është rëndësishme që vlerësimi t'u komunikohet nxënësve në mënyrë të vazhdueshme dhe reale e sidomos kur ata bëjnë një test. Pra, nxënësit duhet të jenë të vetëdijshëm për progresin e tyre që nga fillimi i shkollimit formal të tyre. Nuk rekomandohet që nxënësit të mashtrohen me vlerësime të lartësuar dhe jo reale por as edhe të përdoren me ofendime e etiketime. Mësimit duhet përdorur vlerësimin si mjet për motivimin e nxënësve dhe kjo bëhet më mirë kur ne i njohim nxënësit në detaje dhe u'a identifikojmë anët e forta dhe të dobëta që kanë. Në këtë mënyrë ne nisemi nga anët e forta dhe u'a tregojmë tyre edhe nëvojën për angazhim më të madh në një aspekt të caktuar ku ata nuk tregojnë interesim dhe rezultate. Në këtë mënyrë, nxënësit i shtyejmë që bashkë të planifikojmë objektiva për përmirësim me afate të caktuara kohore. Kështu, nxënësi bëhet pjesëmarrës aktiv në përmirësimin e rezultateve vetanake por edhe ndihet më i përgjegjshëm.

Duke qenë se nxënësit janë nën mbikëqyrjen e prindërve, atyre u duhet raportuar vazhdimisht për progresin e fëmijëve të tyre. Për shkak se raporti prind-fëmijë është shumë subjektiv, nuk është i lehtë të komunikohet me prindin kur kemi kërkesa për angazhim më të madh nga ana e fëmijut të tyre por edhe kur kërkojmë që prindërit të jenë ndihmës në këtë aspekt. Gjithsesi, prindërit janë partner kryesor në komunikim për sa i përket raportimit të suksesit të tyre. Prindërit duhet të informohen për çdo detaj të vlerësimit të nxënësve dhe kjo bëhet përmes rrugëve të ndryshme të drejtëpërdrejta (takime individuale ose grupore) ose jo të drejtëpërdrejta (email, telefon, letër). Vetëm në bashkëpunim dhe me përkrahjen e tyre mund të planifikohet dhe realizohet përkrahja e nxënësve në të nxënë apo sjellje.

Mësimit duhet që të raportojnë për suksesin e nxënësve edhe para këshillit të mësimit dhe ky raportim është i rregulluar me politika të caktuara nga MASHT. Me rëndësi është, që planifikimi i vlerësimit të bëhet në bashkëpunim me kolegët dhe poashtu raportimi të bëhet real dhe bashkërisht të bëhen planet për përmirësim.

Mësimit, raportojnë edhe para drejtorit të shkollës dhe këto vlerësime barten në DKA dhe Sistemin për menaxhimin e informatave në arsimit (SMIA) në kuadër të MASHT. Të dhënat nga vlerësimi i nxënësve, duhet analizuar e duhet përdorur për të sjellur konkluzione për investime në zhvillim profesional të mësimit, investime në pajisje didaktike e teknologjike, për rishikim të planprogrameve e metodologjive mësimore etj.

ANEKS 1 – MODELE TESTE PËR VLERËSIM PËRMBLEDHËS

Test nga lënda e matematikës- Klasa e I-rë

(Vërejtje: Në këtë test janë kombinuar 2 teste nga klasa e parë. Në total janë 14 pyetje, pra 1 test ka 7 pyetje, ndërsa shkalla e notimit në fund të testit është vetëm si shembull dhe vlen vetëm për 7 pyetjet)

- a) Në një degë janë 3 zogj. Nëse këtyre zogjve iu bashkohen edhe 2 zogj, atëherë sa zogj janë gjithsej?



Zgjidhe problemën këtu: _____

- b) Duke vëzhguar figurën, krijo një problemë dhe zgjidhe atë.



(p.sh.) Në figurë janë 7 dallëndyshe. Nëse 2 dallëndyshe janë të mbyllura në kafaz, atëherë sa dallëndyshe janë të lira? $7-2=5$, pra 5 dallëndyshe janë të lira.

Nëse nxënësi zgjidh këtë detyrë, atëherë ai ka arritur këto rezultate të të nxënit të temës: : Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, Kupton shenjat; +, - , =, dhe i përdor ato në rastet e caktuara;


2. Vizato figurat nga bashkësia A në bashkësinë B. Vendosi në të njëjtin vend **10 pikë**

A

B

Nëse nxënësi zgjidh këtë detyrë, atëherë ai ka arritur këtë rezultat të të nxënit të temës: : Shoqëron objektet (elementet) e një bashkësie të dhënë me objektet (elementet) e një bashkësie tjetër.

3. Kopjo figurën: **10 pikë**



Nëse nxënësi zgjidh këtë detyrë, atëherë ai ka arritur këto rezultate të të nxënit të temës: : Përcakton vendin e objekteve, para, prapa, poshtë, lartë, djathtas, majtas, brenda, jashtë, në; Vizaton figurën duke vëzhguar figurën paraprahe;


4. Vendos shenjat; <, >, =. **10 pikë**

$2+4$ $3+2$
 $7-4$ $2+1$
 $5+0$ $6-1$
 $2+3$ $6-4$


Nëse nxënësi zgjidh këtë detyrë, atëherë ai ka arritur këto rezultate të të nxënit të temës: : Kupton shenjat, +, -, >, <, =, dhe i përdor ato në rastet e caktuara; Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 7 duke përfshirë edhe numrin 0)

5. Kryej mbledhjet duke u bazuar në boshtin numerik:

10 pikë



$$\square + \square = \square$$



$$\square - \square = \square$$

Nëse nxënësi zgjidh këtë detyrë, atëherë ai ka arritur këto rezultate të të nxënit të temës: Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta, zbaton mbledhjen dhe zbritjen në problema, kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, me fjalë (në situata reale) bazuar në modelet e dhëna;

6. Vazhdo të vizatosh sipas modelit. Sa shtëpi duhet t'i vizatosh?

10 pikë



1




3

Nëse nxënësi zgjidh këtë detyrë, atëherë ai ka arritur këto rezultate të të nxënit të temës: Vizaton figurën e radhës duke vëzhguar vargun e figurave paraprahe; Identifikon dhe zgjidh problema të thjesht bazuar në modelet e dhëna;


7. Lidhe me shigjetë:

10 pikë



8. Formoni bashkësi me figurat e njëjta


10 pikë




Nëse nxënësi zgjidh këtë detyrë, atëherë ai ka arritur këto rezultate të të nxënit të temës: : Identifikon objektet që janë brenda ose jashtë bashkësisë; Paraqet bashkësinë përmes diagramit të Venit; Krijon bashkësi bazuar në cilësitë e objekteve (elementeve) .

9. Formoni një bashkësi të re nga dy bashkësitë e dhëna, vendos shenjat.

10 pikë




Vendos shenjat <, >, =.



Nëse nxënësi zgjidh këtë detyrë, atëherë ai ka arritur këto rezultate të të nxënit të temës: : Shoqëron objektet (elementet) një bashkësie të dhënë me objektet (elementet) e një bashkësie tjetër; Formon bashkësi nga dy bashkësi të dhëna, Krahason bashkësitë duke përdorur shprehjet; më shumë, më pak, aq sa; Kupton shenjat , >, <, =, dhe i përdor ato në rastet e caktuara

10. Ngjyros dorën e djathtë, ngjyros numri 1 që gjendet në të majtë:


10 pikë



Nëse nxënësi zgjidh këtë detyrë, atëherë ai ka arritur këto rezultate të të nxënit të temës: : Përcakton vendin e objekteve, para, prapa, poshtë, lartë, djathtas, majtas, brenda, jashtë, në;

11. Shkruaj numrat që mungojnë:

10 pikë



Nëse nxënësi zgjidh këtë detyrë, atëherë ai ka arritur këto rezultate të të nxënit të temës: : Lexon dhe shkruan numrat nga 0 deri në 4; Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 0 deri në 4;

12. Vazhdo të vizatosh edhe 4 figura sipas modelit:

10 pikë



Nëse nxënësi zgjidh këtë detyrë, atëherë ai ka arritur këto rezultate të të nxënit të temës: : Vizaton figurën e radhës duke vëzhguar vargun e figurave paraprahe; Modelon katrorin dhe drejtkëndëshin (me plastelinë) dhe mjete të tjera;

13. Vendos shenjat; <, >, =.

10 pikë

$4 \square 3$

$2 \square 2$

$1 \square 3$

$1 \square 2$

$3 \square 1$

14. Lidhe me shigjetë:

10 pikë

Nëse nxënësi zgjidh këtë detyrë, atëherë ai ka arritur këto rezultate të të nxënit të temës: : Kryen veprimin e mbledhjes me numrat deri në 4 dhe krahason numrat natyror duke përfshirë edhe numrin 0.

SHKALLA E NOTIMIT: Deri në 40 pikë (Arritje minimale e RNL), 41-50 (Arritje mesatare e RNL), 51-60 (Arritje e kënaqshme e RNL), 61-70 (Arritje e plotë e RNL).

Test nga lënda Njeriu dhe natyra- Klasa e II-të

1. Familja e Benit ishin shpërngulur nga qyteti për të jetuar në fshat. Pranë shtëpisë së tyre ishte një liqen i madh. Në mbrëmje, Beni mori një shishe plastike, e mbushi me ujë, e vendosi në frigorifer dhe e la që të qëndronte tërë natën. Shkruani në çfarë gjendje ishte uji në momentin kur Beni e mbushi kovën nga liqeni dhe në çfarë gjendje ishte uji në momentin kur e nxori nga frigoriferi.



2. Nëse hapni një shishe plastike të mbushur plotë me ujë e cila ka qëndruar një kohë të caktuar në ambiente ku uji mund të ngrihet do të vëreni se do të kemi disa pikëza uji që do të dalin me shpejtësi nga shishja. Pse ndodh ky proces?

3. Pambuku

Pambuku është bimë barishtore njëvjeçare e familjes mëllagore (Malvaceae), me rrënjë boshtore konike që hyn 1.5-2 m thellë, me kërcell 60-100 cm, me gjethe vezake si zemër të çara, me dhëmbë heshtorë të mprehtë me 3-5-7 vriguj, me lule me petla të mëdha të verdha. Lulëzon në korrik-tetor, bën fryte kapsulë një boçe të rumbullakët me 15-30 fara të mbuluara me fije të holla të bardha.



Disa ditë më parë Enkela dhe Aniku kishin mësuar në shkollë për pambukun por nuk kishin arritur ta kuptonin se pambuku bën pjesë në grupin e materialeve natyrore apo në grupin e materialeve të krijuara nga njeriu.

Jepni mendimin tuaj në lidhje me prejardhjen e pambukut dhe provoni të arsyetoni mendimin.

4. Qarkoni me ngjyrë të gjelbër materialet e krijuara nga natyra dhe me të kuqe materialet e krijuara nga njeriu.



Cila nga figurat e mësipërme bën pjesë në natyrën e gjallë. Tregoni pse mendoni kështu?

5. Familja e zotit Krasniqi kishin vendosur që këtë vit, festën e Vitit të Ri ta festonin në familje. Në mes tjerash, ata kishin planifikuar që të blinin edhe një bredh, por nuk dinin nëse do të blinin një bredh të punuar nga plastika dhe materialet e tjera, apo të blinin një bredh natyral.



A(bredh plastik)




B(bredh natyral)

Tregoni nëse janë të vërteta karakteristikat e mëposhtme për të dy bredhat, atë nga plastika dhe atë të marrë nga natyra.

Rrethoni alternativën e saktë.

	Bredhi A	Bredhi B
-Ka nevojë për ajër	A	B
-Ka nevojë ujë	A	B
-Prodhoet në fabrikë	A	B
-Mund të rritet	A	B
-Bën pjesë në natyrën e gjallë	A	B


6. Diana zhvilloi një eksperiment. Ajo mori një gotë qelqi, një copë letre dhe një enë me ujë. Ajo vendosi copën e letrës në fund të gotës së qelqit. Ngadalë e ktheu gotën përmbys dhe e vendosi në enën e mbushur me ujë. Çfarë mendoni se vërejti Diana posa e largoni gotën nga uji?



Arsyetoni përgjigje tuaj!


7. Termometri është mjeti që shërben për matjen e temperaturës. Temperatura na tregon se sa i nxehet apo i ftohtë është një trup.

Duke e vëzhguar figurën e mëposhtme, tregoni se cili nga termometrat (*A apo B*) tregon temperaturën e ilustruar me fotografi?




Arsyetoni mendimin tuaj!

8. Mrika është në klasën e dytë. Ajo jeton në Prishtinë. Derisa ajo po bëhej gati që të shkonte të flinte, atë e telefonoi nga Amerika kushërira e saj e cila në mes tjerash i tha se po përgatitej që të shkonte në shkollë.
Mrika u habit nga kur dëgjoi fjalët e kushërirës. Çfarë mund të ketë menduar Mrika?



Tregoni arsyet pse në disa vende mund të jetë ditë e në disa vende të tjera mund të jetë natë.

9. Mësuesja u dha një detyrë nxënësve. Ata duhej që të mbillnin nga një lule. Pasi i sollën lulet në klasë mësuesja e pyeti Hanën për lulen e saj. Ajo tha se e kishte mbajtur lulen në një ambient të errët dhe se e kishte ujitur nga 5 herë gjatë ditës. Çfarë mendoni cila është lulja e Hanës. Lulja A apo lulja B?



Arsyetoni mendimin tuaj.

10. Nëse jeni duke kërcyer në një trampolinë, atëherë ju jeni duke bërë lëvizje:

- Rrethore
- Hedhje lartë-poshtë
- Shtyrje para dhe tërheqje prapa
- Lëvizje majtas-djathtas



Test nga lënda Shoqëria dhe mjedisi- Klasa e III-të

1. Më poshtë janë paraqitur disa ilustrime të cilat tregojnë aktivitetin tuaj ditor. Ilustrimet nuk janë të radhitura bazuar në atë që bëni ju çdo ditë.

Ju duhet të tregoni se cili është aktiviteti juaj i parë posa të zgjoheni nga gjumi dhe pastaj të vazhdoni të shkruani edhe për aktivitetet e tjera me radhë.



Fig 1

Fig 2

Fig 3

Fig 4

Fig 5

Në mëngjes unë... _____

2. Që të jetoni të gëzuar në familje, në shkollë dhe në shoqëri, ju keni të drejtat tuaja por keni edhe përgjegjësi. Tregoni cilat janë të drejtat tua në shkollë dhe cilat janë përgjegjësitë tuaja?

Të drejtat e mia në shkollë janë: _____

Përgjegjësitë e mia në shkollë janë: _____

3. Drini kishte dëshirë të blinte një biçikletë që të shëtiste pasditeve pas mësimit, ndërsa motra e tij Alisa dëshironte të blinte një çantë sepse çanta e saj ishte dëmtuar shumë.
(rretho nëse kërkesat e fëmijëve janë nevoja apo dëshira)

Biçikleta e Drinit

Nevojë

Dëshirë

Çanta e Alisë

Nevojë

Dëshirë

Arsyetoni mendimin tuaj në lidhje me përgjigjet që dhatë më lartë.

4. Shkruani disa prej rregullave që ju i zbatoni në klasë.



5. Shkruani për ndonjë prej rregullave të mësipërme të cilin e keni më të vështirë për ta realizuar. Arsyetoni pse e keni të vështirë realizimin e kësaj rregulle.

6. Në ilustrimin e mëposhtëm është paraqitur parku i lojërave për fëmijë. Tregoni se cila do të ishte loja juaj e preferuar në park?



Çfarë duhet të bëni ju në mënyrë që lodrat në park të mos dëmtohen?

7. Shkruaj mendimin tënd për llojin e ndihmës që jepni ju në shkollë, në familje dhe në shoqëri.

Unë e ndihmoj shokun për: _____

Unë i ndihmoj anëtarët e familjes për: _____

Unë ndihmoj të moshuarit për: _____




8. Prindërit e Zanës kishin vendosur që të mbillnin disa fidanë në kopshtin e zyre. Ajo i pa prindërit duke punuar dhe iu që t'i ndihmonte. Çfarë punësh mund të kryej Zana rreth mbjelljes së fidanëve?



9. Shkruani se pse është e nevojshme që të mbillen fidanët dhe çfarë ndikojnë ato në ambientin tonë.

10. Në ilustrim janë paraqitur disa forma të komunikimit nga e kaluara deri më sot.

Shkruani disa fjalë për secilën formë të komunikimit dhe mënyra se si është bërë dhe si bëhet sot.



Sipas imagjinatës suaj, cila mund të ishte forma e komunikimit të së ardhmes? _____

Test nga lënda e matematikës-Klasa IV-të

1. Vera po festonte ditëlindjen. Ajo i bleu në market 5 pako me bombone. Secila pako kishte nga 6 bombone. Dëshira e saj ishte që të iu ndante nga një bombon 32 shokëve e shoqeve të klasës.

A kishte Vera bombone mjaftueshëm për të gjithë shokët dhe shoqet e klasës?

Po

Jo

Çfarë duhet të bëjë Vera, arsyeto veprimin e saj.


2. Ju keni formuar 2 figurat e mëposhtme duke përdorur kube me përmasa të njëjta.

Cila nga format (*A* apo *B*) ka vëllim më të madh?

Kliko një tërësi alternative

A

B




Përdorni fjalë, numra apo figura për të arsyetuar mendimin tuaj.

3. Një bukëpjekës për çdo ditë shiste nga 80 bukë. Për prodhimin e këtyre bukëve ai shpenzonte 40 kg miell. Ditën e diel bukëpjekësi shiti 60 bukë. Sa kg miell ai shpenzoi për prodhimin e 60 bukëve?

4. Për lojën e futbollit Drita-Prishtina janë shitur 1000 bileta. Shikuesit që kishin biletat që përfundonin me numrin 99 ishin fituesit e nga një palë ndërresave të këtyre klubeve. Sa shikues kishin fituar këtë shpërblim?

5. Grafiku paraqet nivelin e ujit të shprehur në metra gjatë viti 2019.

Niveli i ujit në liqenin e Batllavës



Sa metra me ujë kishte liqeni në muajin maj? _____

Në cilin muaj liqeni kishte nivelin më të lartë të ujit? _____

6. Janë dhënë 4 figura.



Fig. 1.



Fig.2



Fig. 3




Fig.4

Sa yje duhet t'i ketë figura e shtatë? _____

Nëse figura ka 16 yje, atëherë me cilin numër të figurës duhet të përcillet kjo figurë? _____

7. Janë vënë themelet e një shtëpie në formën e drejtkëndëshit. Pronari i shtëpisë dëshironte që të kishte më tepër sipërfaqe brenda shtëpisë. Fillimisht u vendos që brinja a të ishte e gjatë 7 metra ndërsa brinja b të ishte 9 metra.



Çfarë do të ndodhte me perimetrin e figurës dhe çfarë me syprinën e sipërfaqes nëse brinja a do të rritej për 1m ndërsa brinja b do të zvogëlohej për 1m?

Arsyeto përmes figurave, fjalive apo vizatimeve etj.


Në cilin rast pronari i shtëpisë do të kishte më tepër sipërfaqe?

8. Cila njësi matëse është më e përshtatshme për matjen e gjatësisë së rrugës Prishtinë – Tiranë?

- a) Metri
- b) Kilometri
- c) Centimetri
- d) Milimetri



9. Cili do të jetë pozicioni i trupit (*konit*) pas rrotullimit prej 180° ?


Pozicioni i tanishëm i trupit 

Rretho pozicionin që do të merr pas rrotullimit prej 180°



10. Sa është syprina e sipërfaqes së hijezuar në figurë nëse një katror është 1cm^2 (shfrytëzo katrorët në figurë)

- a) 22
- b) 23
- c) 21
- d) 20



Test nga lënda e fizikës- Klasa e VI-të

1. Një nga dukuritë e përditshme në fizikë është edhe inercia. Me cilën madhësi fizike identifikohet inercia? MM

- (A) Energjinë
- (B) Masën
- (C) Kohën
- (D) Nxitim

2. Forca me të cilën na tërheq graviteti i Tokës quhet peshë. Me cilën formulë matematike e llogarisim peshën e trupave? MM

- (A) $Q = k x$
- (B) $Q = m g$
- (C) $Q = F a$
- (D) $Q = m - g$

3. Në fotografi është paraqitur një person mbi peshore. Cilën madhësi e përcaktojmë kur matim me Njuton (N)? K

- (A) Forcën
- (B) Masën
- (C) Peshën
- (D) Nxitim



4. Në fizikë dallojmë madhësitë fizike dhe njësitë matëse të tyre.

Cili nga konceptet është i shkruar saktë ? K

- (A) Madhësia fizike shënohet pas vlerës numerike të matur,
- (B) Njësia fizike shënohet pas vlerës së matur numerike,
- (C) Njësia fizike shënohet vetëm me shkronjë të madhe ,
- (D) Madhësia fizike shënohet vetëm me shkronjë të madhe.

5. Gjatë lëvizjes së një makine ajo e ndryshon shpejtësinë. Çka ndodh me nxitimin nëse makina e mban shpejtësinë e pandryshuar ? K

- (A) Nxitimi rritet
 (B) Nxitimi zvogëlohet
 (C) Nuk ndikon fare në nxitim
 (D) Nxitimi është zero




6. Nëse me forcën prej $F=1$ kN, e zhvendosim një trup për rrugën $s = 10$ m, gjatë kohës prej $t=5$ s. Sa fuqi është përdorë me atë rast? Z

- (A) $P = 100$ Ë
 (B) $P = 1000$ Ë
 (C) $P = 2000$ Ë
 (D) $P = 5$ kË

7. Për të kryer punë duhet të harxhojmë (transferojmë) energji të caktuar. Sa energji duhet harxhuar për të gjuajtur topin në distancë 50m me forcë prej 10 N? Z


- (A) 50 J
 (B) 100 J
 (C) 500 J
 (D) 5 kJ



8. Energji potenciale të gravitetit ka çdo trup i ngritur mbi sipërfaqe të tokës. Sa është energjia potenciale e një trupi me masë $m=1$ kg i cili është i ngritur në lartësinë $h=1$ m nga sipërfaqja e tokës, nëse për nxitimin e gravitetit të tokës merret nxitimi $g = 10$ N/kg, sa do të jetë energjia potenciale e këtij trupi? Z

- (A) $E_p = 1$ J
 (B) $E_p = 10$ J
 (C) $E_p = 100$ J
 (D) $E_p = 1$ kJ


9. Në figurë është paraqitur një proces fizik. Për cilin proces bëhet fjalë në figurë? MK



- (A) Kahun e lëvizjes së protoneve,
- (B) Kahun teknik të rrymës elektrike,
- (C) Kahun fizik të rrymës elektrike,
- (D) Kahun e lëvizjes së atomeve.


10. Në figurë është paraqitur një grafik i lëvizjes së njëtrajtshme drejtvizore. Plotësoni tabelën nga të dhënat e grafikut. MK

S(m)	2	4	6
t(s)			




11. Gjatë lëvizjes së ndryshueshme të trupave, ata e ndryshojnë shpejtësinë. Vizatoni pjesët e grafikut në sektorët e shënuar me A,B,C,D, grafikun e lëvizjes sipas kërkesave. MK

- (A) Pjesa A e grafikut - Trupi lëviz duke e rritë shpejtësinë
- (B) Pjesa B e grafikut - Trupi lëviz duke e mbajtur të njëjtën shpejtësi
- (C) Pjesa C e grafikut - Trupi lëviz duke e zvogëluar shpejtësinë
- (D) Pjesa D e grafikut - Trupi nuk është duke lëvizur



- Përgjigja: pjesa A duhet të ketë vijë të drejtë ose të lakuar duke u rritë vlera e rrugës
 Pjesa B duhet të ketë vijë paralele me boshtin
 Pjesa C duhet të ketë vijë të drejtë ose të lakuar duke u zvogëluar vlera e rrugës
 Pjesa D duhet të jetë e vizatuar në boshtin e kohës.



12. Arbeni është duke shikuar televizorin në shtëpi. Në të njëjtën prizë kishte vendosur me kablo vazhduese mbushësin e telefonit si dhe play station. Në dhomë ishte ftohtë, dhe Arbeni e vendosi edhe një ngrohëse me rrymë, por rryma u ndërpre dhe kablo u dogji duke liruar tym. Cila nga përgjigjet e mëposhtme e shpjegon më saktë këtë problem? MK

- (A) Çdo pajisje që u shtua në qark, ishte lidhje paralele dhe e rriti rezistencën e qarkut, duke e shkrië përcjellësin në kablo dhe rryma u ndërpre,
- (B) Çdo pajisje që u shtua në qark, ishte lidhje në seri dhe e rriti rezistencën e qarkut, duke e shkrië përcjellësin në kablo dhe rryma u ndërpre,
- (C) Kablo vazhdues ka pas lidhje të shkurtë dhe rryma është ndërpre,
- (D) Është rregull i rrymës që kur futen në rrymë me shumë se dy shpenzues, rryma ndërpritet.


Test - Kimia 7

1. Në cilën temperaturë uji shndërrohet në gjendje të ngurtë? MM

- (A) $>0^{\circ}\text{C}$
- (B) $<0^{\circ}\text{C}$
- (C) $>100^{\circ}\text{C}$
- (D) $<100^{\circ}\text{C}$

2. Cili proces është paraqitur në figurë? K

- (A) Fotosinteza
- (B) Zbërthimi i ujit në hidrogjen dhe oksigjen
- (C) Qarkullimi i ujit në natyrë
- (D) Ndryshimi i stinëve të vitit



Mësuesi i kimisë në laborator para nxënësve paraqiti dy gota të mbushura me nga 200 cm^3 ujë secila. Ai iu tregoi se njëra është me ujë deti e cila përmban 3.5% kripëra, ndërsa në gotën tjetër ka ujë të distiluar. Përgjigju në tri pyetjet e mëposhtme.

3. Nëse mësimdhënësi do të kërkonte nga ju ti dalloni në cilën gotë është uji i kripur e në cilën gotë uji distiluar, si do të mund ti vërtetoni ato? Trego përgjigjen tuaj duke arsyetuar me argumente veprimin që do ta ndërmerrni. Keni parasysh rregullat e punës në laborator. MK

Përgjigja:

4. Llogarit sa gram kripë ka në gotën me ujë të detit? (Të shënohet procedura e zgjidhjes së detyrës e jo vetëm rezultati). Z

Përgjigja:

5. Sa do të jetë përqindja e kripërave, nëse ujin nga të dyja gotat i përziejme në një enë më të madhe? MK
- (A) Përqindja e kripërave nuk do të ndryshojë (3.5%)
 - (B) Përqindja e kripërave do të rritet për dy herë (7%)
 - (C) Përqindja e kripërave do të zvogëlohet për dy here (1.75%)
 - (D) Përqindja e kripërave pas përzierjes do të mbetet zero (0%).
6. Gjatë stinës së dimrit shpesh ndodh që gypat (tubat) e ujit pëlcastin kur është ftohtë. Pse ndodh ky fenomen? K
- (A) Akulli ka dendësi më të madhe se sa uji në gjendje të lëngët
 - (B) Akulli ka dendësi më të vogël se sa uji në gjendje të lëngët
 - (C) Gypat gjatë stinës së dimrit dobësohen dhe pëcasim më lehtë
 - (D) Uji i ftohtë i gërryen gypat e ujit më lehtë se sa uji i nxehtë
7. Cila nga opsionet e mëposhtme është tretësirë? MM
- (A) Kloruri i natriumit
 - (B) Oksigjeni
 - (C) Uji i distiluar
 - (D) Uji për pije
8. Uji është substanca elementare për zhvillimin e jetës. Shpesh ndodh në përditshmëri që uji të mos shfrytëzohet si duhet. Paraqit një plan të kursimit të ujit në shtëpinë tuaj. Plani duhet të përfshijë së paku tre veprime/aktivitete që janë të realizueshme dhe duke mos ndikuar keq në ushqyerjen dhe higjienën tonë. MK

Tretshmëria e substancave në ujë ndryshon varësisht nga temperatura. Më poshtë është dhënë tabela e tretshmërisë së klorurit të kaliumit (KCl) në 100g ujë në temperaturë të ndryshme. Përgjigjuni në dy pyetjet e dhëna më poshtë.

Temperatura	Tretshmëria e KCl
0°C	28g
20°C	34g
50°C	43g
100°C	56g

9. Sa do të jetë tretshmëria e klorurit të kaliumit (KCl) në temperaturë 80°C ? Z

- (A) 31g
- (B) 51g
- (C) 58g
- (D) 80g

10. Pse në tabelë nuk paraqitet tretshmëria e substancave në ujë në temperaturë mbi 100°C dhe nën 0°C ? MK

Test nga lënda e biologjisë- Klasa e XIII-të

1. Muri qelizor, është pjesë ndërtuese e:

- (A) Qelizës së parashtazorëve.
- (B) Qelizës bimore.
- (C) Qelizës shtazore.
- (D) Qelizës së njeriut.

MM

2. Qelizës për funksionimin e saj i nevojitet në vazhdimësi energjia. Energjinë e siguron në këtë mënyrë:

- (A) Përmes poreve të membranës qelizore, qeliza furnizohet me energji te gatshme.
- (B) Përmes poreve të membranës qelizore, qeliza furnizohet me ushqim i cili sintetizohet në Ribosome.
- (C) Përmes poreve të membranës qelizore, qeliza furnizohet me ushqim i cili oksidohet/digjet në Mitokondrie dhe fitohen molekulat e ATP –së të pasura me energji.
- (D) Kromozomet e qelizës i dyfishojnë molekuat e ADN-së si molekula energjetike kimike, të cilat i shfrytëzon qeliza si burim energjie.

MK

3. Ju si kultivues i një ferme të shpendëve, vazhdimisht i ushqeni pulat me fara misri. Megjithatë pulat e juaja nuk shtojnë në peshë, veterinari konstaton se pulat kanë problem me tretjen. Si duhet të veproni ju në këtë situatë?

- (A) Krahas ushqimit me fara misri ofroni edhe fara gruri.
- (B) Pas qdo ushqimi, ofroni një sasi me të madhe uji, për zbutjen e farave të misrit.
- (C) Bashkë me farat e misrit ofroni edhe një sasi rëre/guralec, që të mundësohet copëtimi mekanik i farave të misrit.
- (D) Në vend të ujit, ju i ofroni pulave sasi acidi për tretjen e farave të misrit.

Z

4. Bazuar në figurën e dhënë më poshtë, tek cilat gjallesa e kemi këtë sistem të qarkullimit të gjakut?

- (A) Qarkullimi i gjakut tek gjitarët.
- (B) Qarkullimi i gjakut tek shpendët.
- (C) Qarkullimi i gjakut tek zvarranikët.
- (D) Qarkullimi i gjakut tek ujëtokësorët.



K

5. Përcjellja e materieve/kripërave në trupin e bimëve enëzore bëhet përmes gypave që quhen

MM

6. Mësimdhënësi juaj kërkon nga ju që të demonstroi efektin e fototropizmit tek bimët. Si do veproni ju?

- A. Do të vendosni për disa ditë një bimë afër dritares ku do të argumentoni se rrënjët e bimës janë zhvilluar më shumë në drejtim të burimit të ujit.
- B. Do të vendosni për disa ditë një bimë afër dritares ku do të argumentoni se gjethet e bimës janë zhvilluar më shumë në drejtim të kundërt me burimin e dritës.
- C. Do të vendosni për disa ditë një bimë largë dritares ku do të argumentoni se gjethet e bimës janë zhvilluar më shumë në drejtim me burimin e dritës.
- D. Do të vendosni për disa ditë një bimë afër derës ku kemi rrymim të ajrit dhe kërcelli i bimës do të lakohet për shkak të ndikimit të forcës së ajrit.

Z

7. Listo së paku katër nga përbërësit kryesor të ushqimit te njeriu?

MM

8. Si mund të ndërlihdni rëndësinë e ushqyeshmërisë me rregulla të caktuara në fazën e pubërtetit?

MK

9. Sipas OBSH-së (Organizatës Botërore të Shëndetësisë), lëndimet e paqëllimta të popullatës së re janë aksidentet e trafikut. Shumica e këtyre aksidenteve janë të lidhura me;

- (A) Ngasjen e veturave të vjedhura.
- (B) Përdorimin e alkoolit dhe narkotikëve.
- (C) Ngasja me bashkëudhëtar.
- (D) Përdorimi i pijeve të ftofta

Z

10. Investimet në shëndetin e adoleshentëve, shkaktojnë efekt pozitiv pasi që:

- (A) Adoleshentët humbin kohë duke ndjekur programe shëndetësore dhe largohen nga organizimet rinore të dëmshme.
- (B) Adoleshentët kursejnë paratë e prindërve dhe shfrytzojnë buxhet institucional.
- (C) Investimi në adoleshentë sjell humbje ekonomike për të ardhmen e vendit dhe rrezikon përkujdesjen ndaj të moshuarve.
- (D) Sjell përfitime ekonomike, produktivitet të rritur, kthim të investimeve dhe kosto më të vogël në të ardhmen.

K

Test nga lënda e kimisë – Klasa IX-të


Tema: Komponimet organike me oksigjen

1. Cila është formula e saktë e etanolit? MM

- (A) CH_3OH
- (B) $\text{C}_2\text{H}_5\text{OH}$
- (C) HCHO
- (D) CH_3COOH

2. Cili është emri i saktë për alkoolin e paraqitur në figurë? Z

- (A) Butan
- (B) Butanol
- (C) Butanol-2
- (D) Butanol-3



3. Nëse një gotë verë lihet e hapur për disa ditë ajo nuk është e sigurtë për tu përdorur. Shpjego në aspektin kimik pse ndodh kjo? MK

4. Lidh emrat e komponimeve me formulat përkatëse. K

Alkool

$\text{CH}_3\text{COOCH}_3$

Aldehyd

$\text{CH}_3\text{CH}_2\text{CH}_2\text{OH}$

Acid karboksilik

CH_3CHO

Ester

HCOOH

5. Radhit komponimet organike me numër të njejtë të atomeve të karbonit sipas pikave të vlimit, duke filluar nga komponimi me pikën më të ultë deri tek ai më të lartë. Shëno me numra nga 1-4, ku 1 komponimi me pikën më të ultë, ndërsa 4 komponimi me pikën më të lartë. MK

Alkool	
Aldehyd	
Acid karboksilik	
Ester	

6. Përdorimi i alkoolit është i ndaluar të konsumohet nën moshën 18 vjeç. Jep së paku dy arsyetime pse kjo rregull është e nevojshme. MK

7. A mund të jenë izomer mes vete një keton dhe një acid karboksilik? Pse po ose pse jo, shpjego përgjigjen tuaj? MK

8. Cili është emri i zakonshëm për acidin etanoik? MM

- (A) Acidi acetik
- (B) Acidi formik
- (C) Aceton
- (D) Acidi citrik

Në një gotë poç (balon) janë vendosur 25ml etanol dhe 25ml acid etanoik. Kësaj përzierje i shtohen edhe 5 pika acid sulfurik dhe tretësira ngrohet. Gjatë reaksionit që zhvillohet do të përfitohet ester dhe ujë. Përgjigjuni në dy pyetjet e mëposhtme për këtë eksperiment.

9. Si mund ta dallojmë që është përfituar esteri? Për fjalitë e sakta vendos shenjën “√”, ndërsa për fjalinë e gabuar shenjën “X”. K

Esteri i formuar noton mbi ujë.	<input type="checkbox"/>
Esteri i formuar fundërrohet.	<input type="checkbox"/>
Tretësirës fillon ti vije aromë e këndshme.	<input type="checkbox"/>
Tretësirës fillon ti vije aromë e pakëndshme.	<input type="checkbox"/>
Gjatë këtij reaksioni nuk mund ta vërejmë asnjë ndryshim.	<input type="checkbox"/>

10. Cili është emri i saktë i esterit të përfituar? Z

- (A) Etanoat i metilit
- (B) Etanoat i etilit
- (C) Metanoat i metilit
- (D) Butanoat

7. Gëzimi dhe Blerimi blenë tel për të rrethuar kopshtin e tyre. Kopshti i Gëzimit kishte formë drejtkëndëshe me gjatësi **8.76 m** dhe gjërësi **9.7 m**, ndërsa kopshti i Blerimit kishte formë katrore me gjatësi dhe gjërësi **6.68 m**. Cilit iu desht të blente më shumë tel?

8. Zana ,Yllka dhe Driloni kishin grumbulluar në arkën e kursimeve **157.23 €**. Ato para duhej t'i ndanin në mënyrë të barabart për shpenzimet e tyre ditore gjatë pushimeve verore. Në pushime do të rrinin 12 ditë. Sa para do të shpenzojnë afërsisht për një ditë pushimi?

7. Lidhni me shigjetë emrin e figurës gjeometrike me formulën përkatëse për njehësimin e perimetrit

Katrori $P = 2r\pi$

Paralelogrami $P = a+b+c+d$

Rrethi $P = 4a$

Trapezi $P = 2(a+b)$


8. Njehësoni syprinën e sipërfaqes së trekëndëshit kënddrejtë me katete $a = 3\text{cm}$ dhe $b = 6\text{cm}$:

Plotësoni tabelën:

r (rrezja e rrethit)	
P (perimetri i rrethit)	
S (syprina e sipërfaqes së rrethit)	12.56 dm ²

9. Njehëso syprinën e sipërfaqes në figurën e dhënë:

4cm 2 cm



TEST NË MATEMATIKË

Gr. B

(detyrat 8,9 dhe 10 duhet të zgjidhen në pjesën e pasme të fletës)

Emri dhe mbiemri _____ kl. _____ Pikët _____ Nota _____

1. Formula për llogaritjen e gjatësisë së katetës a te trekëndëshi kënddrejtë është $a = \sqrt{c^2 + b^2}$

a) E saktë

b) E pasaktë

2. Perimetri i shtatëkëndëshit të rregullt me brinjë $a = 3.5$ cm është :

a) 245 cm

b) 24.5 cm

c) 10.5 cm

3. Shkruani formulën për njehësimin e syprinës së sipërfaqes së deltoidit

4. Me formulën $S = \frac{(a+b) \cdot h}{2}$ llogaritet syprina e sipërfaqes së _____.

5. Perimetri i sipërfaqes rrethore është i barabartë me prodhimin e _____ dhe të _____.

6. Teorema e Pitagorës thotë: Te çdo trekëndësh kënddrejtë shuma e sipërfaqeve katrore të ndërtuara mbi _____ është e barabartë me sipërfaqen katrore të ndërtuar mbi _____.

7. Lidhni me shigjetë emrin e figurës gjeometrike me formulën përkatëse për njehësimin e perimetrit

Trapezi	$P = 2r\pi$
Rrethi	$P = a+b+c+d$
Paralelogrami	$P = 4a$
Katrori	$P = 2(a+b)$

8. Njehësoni syprinën e sipërfaqes së trekëndëshit kënddrejtë me katete $a = 5\text{cm}$ dhe $b = 8\text{cm}$:

Plotësoni tabelën:

r (rrezja e rrethit)	
P (perimetri i rrethit)	18.84 m
S (syprina e sipërfaqes së rrethit)	

9. Njehëso syprinën e sipërfaqes në figurën e dhënë:

6cm 3cm



Test tematik në matematikë

1. Temperatura 10°C nën zero shkruhet:

- a) $+10^{\circ}\text{C}$ b) 10°C c) -10°C

2. Numri -5 është numër _____ i numrit 5 .

3. Radhitni nga më i vogli kah më i madhi numrat : $8, -8, 6, -7, 3, 0, -4, -9$

4. “Dy numra me shenja të njëjta mblidhen duke e përshkruar shenjën, ndërsa numrat zbriten.”

- a) e saktë b) e pasaktë

5. Cili numër duhet të vendoset në drejtkëndëshin e zbrazët që barazimi $18 - \square = 35$ të jetë i sakt

- a) -53 b) 17 c) -17

6. Në tabelën e mëposhtme jepen temperaturat mesatare të ajrit të një sezone dimri

Nëntor	Dhjetor	Janar	Shkurt
3	0	-4	-2

Vendosni vlerat e temperaturave në drejtëzën numerike.



7. Mërkuri i lëngshëm (zhiva) ngrin në temperaturën -39°C dhe vlon në temperaturën 357°C . Cili është ndryshimi i temperaturës ndërmjet dy gjendjeve?

8. Një aeroplan fluturon në lartësi **7500 metra** mbi nivelin e detit. Nëndetësja ndodhet në vijë të drejtë poshtë aeroplanit në thelësinë **60 metra**. Sa metra larg nëndetësës është aeroplani?
9. Kur u lind Jul Çezari kur e dijmë se ai vdiq në moshën **57 vjeç** në vitin **44 para erës sonë**?
10. Ditën e hënë temperatura në Prishtinë ishte **-3C**. Ditën e enjte ra me **3C**, ditën e shtunë u rrit me **9C**.
- a) Sa ishte temperatura ditën e enjte?
 - b) Sa ishte tempreatura ditën e shtune?
 - c) Sa ndryshoi temperatura nga dita e hënë në të shtunën?



Deutsche Gesellschaft für
Internationale
Zusammenarbeit (GIZ)
GmbH

Zyra Prishtinë
Rr. Anton Çeta Nr. 1
10000 Prishtinë
Republike e Kosovës

T +381 38 233 002 206
F +381 39 233 002 173
E giz-kosovo-buero@giz.de
I www.giz.de